

RAPORTI I VEPRIMTARISË 2025

ARRITJET DHE PRIORITETET
STRATEGJIKE PËR TË ARDHMEN



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RAPORTI I VEPRIMTARISË
PËR VITIN
2025

Tiranë, 2026

© 2026

Ky raport dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë e drejtë autori. Të gjithë të drejtat janë të rezervuara për Bordin e Mbikëqyrjes Publike në Shqipëri. Kopjimi dhe përhapja e të dhënave apo përdorimi tregtar i këtij raporti nuk është i lejuar përveç kur jepet miratim me shkrim. Është i ndaluar vendosja e këtij raporti në faqe interneti edhe kur kjo bëhet pa pagesë, nëse nuk është marrë aprovimi paraprak nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Përdorime të tjera që nuk parashikohen në këtë seksion janë të lejuara vetëm nëse burimi i informacionit citohet me saktësi “Bordi i Mbikëqyrjes Publike i Shqipërisë”.

PËRMBAJTJA

Akronime	5
1. Përmbledhje ekzekutive	6
2. Përbërja dhe detyrat e Bordit të Mbikëqyrjes Publike	8
2.1. Përbërja e BMP	9
2.2. Konstituimi i BMP	9
2.3. Të drejtat dhe detyrat e BMP	10
2.3.1 Aktet nënligjore të miratuara nga BMP për vitin 2025	11
2.3.2 Financimi i veprimtarisë së Bordit të Mbikëqyrjes Publike	13
3. Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2025.....	15
3.1. Funkzionimi i komisioneve të ngritura pranë BMP	15
3.1.1 Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale	15
3.1.2 Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës	17
3.1.3 Komisioni Ligjor.....	19
3.1.4 Komisioni i Rishikimit.....	20
4. Forcimi i Cilësisë së Auditimit: Mbikëqyrja, Zhvillimi Profesional dhe Treguesit e Cilësisë.....	21
4.1. Cilësia në auditim.....	21
4.2. Kontrolli i sigurimit të cilësisë dhe forcimi i kapaciteteve	22
4.2.1 Rritja e kapaciteteve të strukturës mbështetëse në kuadër të mbikëqyrjes të cilësisë së auditimit	22
4.2.2 Forcimi i Cilësisë së Auditimit në Shqipëri: Reformat dhe bashkëpunimet për transparencë dhe integritet	24
4.2.3 Konkurrenca në tregun e auditimit.....	25
4.2.4 Renditja e subjekteve	28
4.3. Mbikëqyrja për sigurimin e cilësisë	30
4.4. Kontrolli i sigurimit të cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik -	36
4.5. Rezultatet e arritura - Treguesit e cilësisë së auditimit	38
5. Mbikëqyrja e organizatave profesionale.....	41
5.1. Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Audituesve Ligjorë	41
5.2. Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar	42

6.	Bashkëpunime ndërinstitucionale dhe institucionet homologe ndërkombëtare	43
6.1.	Anëtarësimi i BMP në IFIAR – Angazhim për Cilësi dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar	44
6.2.	Roli i BMP në Grupin e Punës për Zbatimin e Masave Disiplinore – IFIAR Enforcement Working Group.....	45
6.3.	Roli i BMP si anëtar vëzhgues në Komitetin e Autoriteteve Evropiane të Mbikëqyrjes së Auditimit (CEAOB)	46
6.4.	Bashkëpunimi me Bankën Botërore për Forcimin e Kapaciteteve dhe Cilësisë së Auditimit	47
6.5.	Bashkimi Evropian – Progres Raporti.....	48
6.6.	Bashkëpunimi me rregullatorë të tjerë në rajon dhe organizata të tjera rajonale	49
7.	Prioritetet dhe objektivat për vitin 2026	50
7.1.	Mbikëqyrja dhe sigurimi i cilësisë të auditimit ligjor	50
7.2.	Mbikëqyrja e hyrjes në profesion dhe procesit të provimit të aftësive profesionale .	50
7.3.	Kontributi i BMP në forcimin e kuadrit AML/CFT dhe procesin e integritetit evropian	51
7.4.	Roli dhe kontributi i BMP në përmbushjen e Kapitullit 6 të <i>acquis</i> të BE-së (“Legjislacioni për shoqëritë tregtare”).....	52
7.5.	Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe zhvillimi profesional i stafit, dhe përmirësimi i efektivitetit institucional	52
7.6.	Mbikëqyrja e organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale	53
7.7.	Mbikëqyrja e profesionit të kontabilistëve të miratuar	54
7.8.	Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në funksion të stabilitetit financiar dhe cilësisë së raportimit.....	54
8.	<i>Aneks - Pasqyrat Financiare me Raportin e Audituesit të Pavarur më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025</i>	57

Akronime

AL	Auditues Ligjorë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BMP	Bordi i Mbikëqyrjes Publike
BSH	Banka e Shqipërisë
BSNEPK (IESBA)	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël
CFRR	Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
FATF	Taks Forca e Veprimit Financiar
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
IFIAR	Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Auditimit
KIDB	Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike
KM	Kontabilist i Miratuar
KPAP	Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale
NIP/NJEIP	Njësi Ekonomike me Interes Publik
NUIS (NIPT)	Numri Unik i Identifikimit të Shoqërisë
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKK (NAS)	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
SNA (ISA)	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKC1 (ISQC1)	Standardi Ndërkombëtar i Kontrollit të Cilësisë 1
SNRF (IFRS)	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
SNMC 1	Standardi Ndërkombëtar i Menaxhimit të Cilësisë 1
SNMC 2	Standardi Ndërkombëtar i Menaxhimit të Cilësisë 2
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet një panoramë mbi aktivitetet dhe punën e zhvilluar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) përgjatë vitit 2025 në funksion të mbikëqyrjes së audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, kontabilistëve të miratuar, si dhe organizatave profesionale përkatëse. Gjatë vitit raportues, BMP ka vijuar të konsolidojë rolin e tij si autoriteti kryesor mbikëqyrës i profesionit të auditimit në Shqipëri, duke kontribuar në forcimin e cilësisë së auditimit ligjor, rritjen e transparencës së raportimit financiar dhe avancimin e procesit të përafrimit me acqui të Bashkimit Evropian. Aktiviteti është karakterizuar nga një qasje e integruar që ndërthur reformat ligjore dhe rregullatore, mbikëqyrjen efektive, zhvillimin institucional dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, në kuadër të krijimit dhe rritjes së sigurisë së auditimit kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar, të kujdesshëm dhe në shërbim të interesit të publikut.

Një nga arritjet më të rëndësishme gjatë kësaj periudhe është hartimi dhe miratimi i një sërë aktesh nënligjore në zbatim të ndryshimeve të fundit ligjore, me qëllim përafrimin e plotë të kuadrit rregullator me kërkesat e Direktiva 2006/43/EC dhe Rregullorja (EU) 537/2014. Këto rregullore kanë adresuar fusha kyçe si sigurimi i cilësisë, investigimi dhe masat disiplinore, mbledhja e të ardhurave, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe funksionimi i regjistrimit publik, duke forcuar bazën ligjore dhe institucionale të mbikëqyrjes. Procesi është zhvilluar në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet konsultimeve të gjera me organizatat profesionale dhe palët e interesuara.

Në aspektin e mbikëqyrjes së cilësisë, BMP ka vijuar të zbatojë një qasje të bazuar në risk, duke realizuar një numër të konsiderueshëm kontrollesh të sigurimit të cilësisë gjatë viteve të fundit. Në total, janë kryer 45 kontrole, duke përfshirë auditues ligjorë dhe shoqëri audituese, si dhe për herë të parë është zbatuar delegimi i kontrollit të cilësisë për 45 audituesë ligjorë të angazhuar në auditimin e njëjësive jo me interes publik tek Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Në tërësi procesi i kontrollit të sigurimit të cilësisë ka identifikuar sfida të rëndësishme, duke përfshirë nevojën për përditësimin e sistemeve të kontrollit të cilësisë sipas standardeve ndërkombëtare (SNMC1 dhe SNMC2), përmirësimin e dokumentimit të evidencës së auditimit dhe forcimin e lidhjes ndërmjet procedurave dhe konkluzioneve. Megjithatë, niveli i lartë i bashkëpunimit nga subjektet e kontrolluara dhe angazhimi i tyre për zbatimin e planeve të përmirësimit përbëjnë një tregues pozitiv për zhvillimin e mëtejshëm të profesionit.

Rezultatet e kontrolleve kanë evidentuar përmirësime të ndjeshme në cilësinë e auditimit dhe në organizimin e brendshëm të punës së audituesve, të reflektuara edhe në zhvillimin e tregut të auditimit. Të ardhurat nga shërbimet e auditimit kanë shënuar një rritje mesatare vjetore prej 14.38%, duke tejkaluar ndjeshëm rritjen e numrit të njëjësive të audituara. Ky zhvillim tregon një zhvendosje të tregut drejt një modeli konkurrues të bazuar në cilësi dhe vlerë të shtuar, në përputhje me objektivat strategjike të reformës së sektorit.

Në nivel ndërkombëtar, përfshirja aktive e BMP në IFIAR dhe veçanërisht në Grupin e Punës për Masat Shtrënguese përfaqëson një element të rëndësishëm të strategjisë institucionale për forcimin e rolit rregullator, rritjen e kapaciteteve dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare. Këto angazhime synojnë jo vetëm përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe mbikëqyrjes, por

gjithashtu rrisin besimin e publikut dhe investitorëve në integritetin e sistemit të raportimit financiar në Shqipëri.

Gjithashtu BMP miratimi i anëtar vëzhgues në Committee of European Auditing Oversight Bodies (CEAOB) shënon një tjetër arritje që përfaqëson një njohje të rëndësishme të progresit të Shqipërisë në harmonizimin e kuadrit të auditimit me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe krijojnë mundësi për shkëmbim përvojash dhe përmirësim të mëtejshëm të praktikave mbikëqyrëse. Ky angazhim përforcon rolin e BMP si një institucion modern dhe proaktiv në mbrojtje të interesit publik.

Reformat e drejtuara nga Ministria e Financave, me mbështetjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë – Bankës Botërore dhe SECO, rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe afatgjatë – të lidhura me përmirësimin e raportimit financiar në sektorin privat dhe më gjerë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, të projektuara për të qenë të qëndrueshme, kanë ndikuar në ndërtimin e kapaciteteve teknike të mjaftueshme që institucionet e kuadrit të raportimit financiar të përditësojnë dhe zbatojnë kuadrin ligjor, standardet profesionale dhe aktivitetet mbikëqyrëse. Efektiviteti i mbikëqyrjes së auditimit ligjor kanë sjellë rezultatin që ky shërbim të mos perceptohet më si një shërbim me kosto të ulët dhe i drejtuar nga përputhshmëria, por të nxisë konkurrencën të bazuar në cilësi. Forcimi i kapaciteteve e ka pozicionuar Bordin e Mbikëqyrjes Publike si një rregullator të besueshëm dhe efektiv, i aftë për të mbrojtur dhe qëndrueshëm rezultatet e reformave, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillim afatgjatë dhe integrim evropian.

Forcimi i bashkëpunimit me organizatat profesionale, veçanërisht me IEKA, ka qenë një tjetër shtyllë e rëndësishme e aktivitetit të BMP. Përpjekjet janë fokusuar në përmirësimin e sistemit të edukimit dhe kualifikimit profesional, zhvillimin e programeve të kualifikimit të vijueshëm dhe rritjen e standardeve etike dhe profesionale. Këto iniciativa synojnë të garantojnë që hyrja në profesion dhe zhvillimi i mëtejshëm i audituesve të përputhet me kërkesat në rritje të tregut dhe standardeve ndërkombëtare.

Viti 2025 dëshmon se është arritur një progres i konsiderueshëm në drejtim të forcimit të sistemit të mbikëqyrjes së auditimit, rritjes së cilësisë së auditimit përmes një kombinimi të qartë të politikave rregullatore, mbikëqyrjes efektive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, duke mbështetur njëkohësisht zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia Roli i BMP si mbikëqyrës i procesit të provimeve të aftësive profesionale është thelbësor për garantimin e cilësisë së hyrjes në profesion dhe besueshmërisë së sistemit të certifikimit. Në këtë kuadër, BMP i ka dhënë prioritet të menjëhershëm sigurimit të vijueshmërisë së këtij procesi, në dritën e shtyrjes së tij nga viti 2025. Gjatë vitit 2026, janë ndërmarrë masa konkrete dhe të mirë strukturuara, që synojnë garantimin e zhvillimit të rregullt dhe transparent të këtij procesi, si dhe forcimin e kapaciteteve organizative dhe mbikëqyrëse. Kjo qasje synon jo vetëm sigurimin e vazhdimësisë së procesit, por edhe rritjen e besimit të kandidatëve dhe publikut në integritetin dhe efektivitetin e sistemit të provimeve.

2. Përbërja dhe detyrat e Bordit të Mbikëqyrjes Publike

BMP u krijua në tetor 2009 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Ndryshimet e reja ligjore përmirësuan ndjeshëm rolin e BMP-së duke pasqyruar vizionin e institucioneve homologe të Bashkimit Evropian dhe kërkesat e rregullores 537 të BE-së.

Pas këtyre ndryshimeve, BMP ka marrë statusin e autoritetit të pavarur rregullator, si person juridik publik, për realizimin e mbikëqyrjes publike të profesionit të auditimit dhe shoqërive të auditimit, si drejtpërdrejtë, ashtu edhe nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë. BMP është gjithashtu autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e profesionit të kontabilistëve të miratuar dhe organizatave profesionale përkatëse.

Përmirësimi i mjedisit të auditimit nuk do të ishte i mundur pa burimet njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara. Bazuar në përcaktimet e ligjit të sipërpërmendur dhe me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 786/2016, i ndryshuar, u mundësua krijimi i një strukture mbështetëse të angazhuar me kohë të plotë me qëllim realizimin dhe ndjekjen në vazhdimësi të veprimtarisë së BMP-së. Aktualisht, struktura mbështetëse e BMP përbëhet nga një personel prej 7 (shtatë) ekspertësh të kualifikuar, duke përfshirë 3 (tre) inspektorë të lartë të sigurimit të cilësisë, si edhe komisioneve të ngritur nga Bordi si pjesë e kësaj strukture. Në këtë kuadër, një rol thelbësor luhet nga inspektorët e sigurimit të cilësisë, të cilët, përmes një pune të palodhur dhe të vazhdueshme në terren, kontribuojnë drejtpërdrejt në forcimin e cilësisë së auditimit dhe rritjen e besimit publik në profesion. Angazhimi i tyre karakterizohet nga profesionalizëm i lartë, pavarësi në gjykim dhe përkushtim ndaj standardeve më të mira ndërkombëtare. Integriteti i tyre i spikatur reflektohet në mënyrën rigoroze dhe të paanshme me të cilën kryejnë vlerësimet, duke garantuar që proceset e kontrollit të cilësisë të jenë të besueshme, transparente dhe në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Përmes këtij angazhimi, ata jo vetëm identifikojnë dhe adresojnë mangësitë, por gjithashtu kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave profesionale në treg.

Misioni i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është mbikëqyrja publike e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, organizatave profesionale të audituesve ligjorë si dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar me qëllim përmbushjen e objektivave publike në mbështetje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, kuadrit rregullator dhe në shërbim të interesit publik.

Objektivi kryesor i BMP-së është të rrisë sigurinë që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik. Në ushtrimin e funksionit rregullator dhe mbikëqyrës, BMP udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

2.1. Përbërja e BMP

Bordi i Mbikëqyrjes Publike përbëhet nga pesë anëtarë jo-praktikues, të cilët janë ekspertë në fusha të lidhura me auditimin ligjor, emëruar nga Ministri përgjegjës për financat, me mandat për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtën për t'u rizgjedhur jo më shumë se dy herë. Anëtarët e Bordit janë përzgjedhur bazuar në kritere të përcaktuara dhe përmes një procedure konkurruese të pavarur dhe transparente bazuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, VKM-së nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, i ndryshuar, si edhe në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 29/1, datë 01.12.2021 “Për emërimin dhe mandatimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike” dhe konstituimi i këtij Bordi u bë më datë 23.12.2021.

Përbërja e Bordit të Mbikëqyrjes Publike për periudhën e veprimtarisë të reflektuar në këtë raport është si në vijim:

1. Kryetar - Z. Dritan Fino;
2. Anëtar - Znj. Adriana Berberi;
3. Anëtar - Z. Luan Abazi;
4. Anëtar - Z. Martin Mici;
5. Anëtar - Z. Gjergji Duro.

Gjatë vitit 2025, BMP, me përbërjen sa më lart përmendur, ka zhvilluar 15 mbledhje dhe ka marrë 61 vendime me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të parashikuara në ligj. Vendimet e Bordit janë marrë në transparencë të plotë, duke respektuar parimin e kolegjalitetit.

Në përmbushjen e funksioneve të veta, Bordi i Mbikëqyrjes Publike asistohet nga Struktura Mbështetëse dhe drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv Znj. Erjola Vejzati

Struktura Mbështetëse përbëhet nga tre inspektorë të lartë të kontrollit të cilësisë dhe stafi administrativ, të cilët kanë një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e auditimit ligjor, raportimit financiar dhe ekspertizës në kontrollin e cilësisë së auditimit ligjor, kuadrit ligjor dhe fushave të lidhura me parandalimin dhe pastrimin e parave, standardeve ndërkombëtare të edukimit, etj.

2.2. Konstituimi i BMP

Gjatë vitit 2026, Bordi i Mbikëqyrjes Publike u ri themelua i përbërë nga pesë anëtarë jo-praktikues, të cilët janë ekspertë në fusha të lidhura me auditimin ligjor, të emëruar nga Ministri përgjegjës për financat, me mandat për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtën për t'u rizgjedhur jo më shumë se dy herë. Anëtarët e Bordit janë përzgjedhur bazuar në kritere të përcaktuara

dhe përmes një procedure konkurruese të pavarur dhe transparente bazuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, VKM-së nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, i ndryshuar, si edhe në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 153/3, datë 27.02.2026 “Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike” dhe konstituimi i këtij Bordi u bë më datë 06.03.2026.

Aktualisht, Bordi i Mbikëqyrjes Publike përbëhet nga anëtarët në vijim:

1. Kryetar - Znj. Elira Hoxha;
2. Anëtar – Znj. Sanije Tafa;
3. Anëtar – Z. Lirim Sulaj.
4. Anëtar – Znj. Dorida Marku;
5. Anëtar – Znj. Enslemvera Zake.

2.3. Të drejtat dhe detyrat e BMP

Ndryshimet ligjore që hynë në fuqi në janar 2025 kanë sjellë një forcim të ndjeshëm të rolit dhe përgjegjësisë të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP), duke konsoliduar më tej funksionin e tij si autoritet i pavarur mbikëqyrës në përputhje me praktikën më të mira evropiane. Krahas vazhdimësisë së funksioneve tradicionale në fushën e mbikëqyrjes së regjistrimit, kontrollit të cilësisë, etikës dhe disiplinës profesionale, kuadri i ri ligjor ka zgjeruar ndjeshëm kompetencat rregullatore dhe institucionale të BMP. Ndryshimet ligjore kanë sjellë përgjegjësi të reja që lidhen me hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare të vetë institucionit, si edhe auditimin e tyre, si dhe me nxjerrjen e akteve nënligjore, udhëzimeve, metodologjive etj., të cilat publikohen në Fletoren Zyrtare. Gjithashtu, BMP tashmë ka një rol më të qartë në shpalljen e standardeve profesionale të detyrueshme dhe në rregullimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndër-institucional, brenda dhe jashtë vendit. Këto zhvillime reflektojnë një rritje të ndjeshme të përgjegjësisë përse i përket funksioneve mbikëqyrëse, duke forcuar njëkohësisht transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin institucional të BMP.

Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, neni 5, BMP ka këto të drejta dhe detyra:

- harton rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat i paraqiten për miratim autoriteteve të parashikuara në ligjin e auditimit;

- mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
- miraton formatin e regjistrimit publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Komiteti i Regjistrimit, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistër;
- miraton kodin e etikës të audituesve ligjorë e të shoqërive audituese, të përgatitur dhe të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe mbikëqyr zbatimin e standardeve të këtij kodi;
- mbikëqyr kontrollin e cilësisë, që realizohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë;
- miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
- kur e gjykon të nevojshme, kryen investigime shtesë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;
- shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
- miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të tij;
- shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;
- shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në këtë ligj, që janë brenda objektit të veprimtarisë së tij;
- harton dhe miraton pasqyrat financiare të tij në përputhje me kërkesat përkatëse të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe miraton audituesin ligjor ose shoqërinë audituese të tyre;
- nxjerr akte, që janë rregullat, rregulloret, urdhrat, udhëzimet, manualët apo metodologjitë, në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin e funksionimit të tij. Aktet me karakter normativ rregullator botohen në Fletoren Zyrtare;
- shpall të detyrueshme standardet profesionale të zbatueshme nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit në përputhje me fushëveprimin e këtij ligji, të cilat botohen në Fletoren Zyrtare;
- miraton aktet rregullatore lidhur me bashkëpunimin e shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit.

2.3.1 Aktet nënligjore të miratuara nga BMP për vitin 2025

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 126/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) nisi procesin e analizës dhe përshtatjes së dispozitave të reja ligjore dhe hartimin e akteve nënligjore, duke

realizuar konsultimin me organizatat profesionale dhe publikimin në faqen zyrtare të web për komente nga palët e interesuara. Këto akte synojnë përafrim të mëtjshëm me kërkesat e Direktivës 2006/43/EC dhe Rregullores (EU) 537/2014, si dhe kanë në fokus përputhjen me kërkesat përkatëse lidhur me etikën profesionale, pavarësinë, objektivitetin, konfidencialitetin dhe sekretin profesional, standardet e auditimit dhe raportimi i auditimit, sigurimin e cilësisë dhe sistemet e dhënies së sigurisë për cilësinë, sistemin e investigimit dhe sanksionimit, efektivitetit të sanksioneve.

Në Gusht 2025, pasi u realizua konsultimi me organizatat profesionale, si edhe është publikuar për komente, BMP ka miratuar Rregulloren “*Për procedurat dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike*”, e publikuar në fletoren zyrtare Nr.158 datë 08.09.2025. Kjo rregullore synon forcimin e kapaciteteve nëpërmjet përmirësimit dhe qartësisimit të procedurave dhe rregullave të mbledhjes së të ardhurave, sipas burimeve të financimit të veprimtarisë të përcaktuara në nenin 4/1 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Në vijim, në periudhën Shtator 2025, pasi u realizua konsultimi me organizatën profesionale të audituesve ligjorë, si edhe janë publikuar për komente nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, BMP ka miratuar Rregulloren “*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit*”, e publikuar në fletoren zyrtare Nr.183 datë 09.10.2025.

Dispozitat e parashikuara në këtë rregullore kanë përafruar kërkesat e Direktivës 2006/43/EC dhe Rregullores (EU) 537/2014, për auditimin, për të gjitha dispozitat që lidhen me:

- i. procedurat, metodologjinë dhe kërkesat për organizimin dhe funksionimin e sistemit të brendshëm për sigurimin e cilësisë si dhe për kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit, nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- ii. kuadrin rregullator të mbikëqyrjes nga BMP për mbrojtjen e interesit publik, nëpërmjet kontrollit të sigurimit të cilësisë të auditimit ligjor dhe, ku është e zbatueshme të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;
- iii. rregullat e detajuara në zbatim të kërkesave të ligjit për auditimin dhe të kërkesave përkatëse të kodit të etikës në fuqi për auditimin dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në lidhje me përgatitjen për auditimin ligjor dhe vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë, ruajtjen e pavarësisë dhe objektivitetit, ndalimin e shërbimeve të jo të auditimit, parregullsitë e identifikuar në njësinë ekonomike kur kryhet auditimi ligjor dhe/ose dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë për një njësi ekonomike me interes publik;
- iv. rregullat për transferimin e informacionit;
- v. rregullat dhe kërkesat të posaçme në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si edhe të raportit të dhënies së sigurisë për raportin vjetor e të konsoliduar të qëndrueshmërisë;

vi. rregullat e detajuara në lidhje me raportimin në komitetin e auditimit.

Gjithashtu, po në këtë periudhë është miratuar Rregullorja “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”, e publikuar në fletoren zyrtare Nr.183 datë 09.10.2025.

Dispozitat e parashikuara në këtë rregullore kanë përafruar të gjitha kërkesat e Direktivës 2006/43/EC për auditimin, lidhur me: (i) sistemin e investigimit dhe marrjen e masave disiplinore dhe sanksionuese; dhe (ii) zbatimin efektiv të masave disiplinore dhe sanksionuese, duke përcaktuar si në vijim:

i. kërkesat ligjore që lidhen me investigimin dhe marrjen e masave disiplinore nga ana e Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP);

ii. parimet për vendosjen e masave disiplinore jo me qëllim ndëshkimin, por mbrojtjen e interesit të publikut dhe zbatimin e një sistemi efektiv dhe proporcional të procesit të investigimit dhe marrjes së masave disiplinore;

iii. parimet e përgjithshme të funksionimit të procesit të investigimit dhe të marrjes së masave disiplinore nga ana e BMP me qëllim zbulimin, korrigjimin e parandalimin e shkeljeve dhe sjelljeve të papajtueshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

Në nëntor 2025 është miratuar Rregullorja “Për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit”, e publikuar në fletoren zyrtare Nr.230 datë 11.12.2025, duke përcaktuar parimet, procedurat, format dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) dhe autoriteteve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, në funksion të sigurimit të mbikëqyrjes efektive në fushën e auditimit dhe raportimit financiar.

Gjithashtu, po në nëntor 2025 është miratuar Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrimit publik”, e publikuar në fletoren zyrtare Nr.230 datë 11.12.2025, e cila përcakton rregullat dhe procedurat për organizimin, funksionimin e Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, si edhe mbikëqyrjen e respektimit të rregullave gjatë procesit të regjistrimit në Regjistrin Publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistrë.

2.3.2 Financimi i veprimtarisë së Bordit të Mbikëqyrjes Publike



Auditimet e pavarura dhe të vazhdueshme të pasqyrave financiare me cilësi të lartë përbëjnë një shtyllë themelore për garantimin e raportimit financiar të besueshëm dhe të përshtatshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit. Në këtë kontekst, aktiviteti mbikëqyrës i ushtruar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) luan një rol kyç në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së auditimit dhe në mbrojtjen e interesit publik.

Burimet financiare të siguruar nga honorarët e auditimeve të njësive ekonomike me interes publik, si dhe nga kontributet e organizatave profesionale të mbikëqyrura, nuk përbëjnë thjesht një mekanizëm financimi, por janë të orientuara drejtpërdrejt drejt rritjes së cilësisë së auditimit. Këto burime mundësojnë forcimin e funksionit mbikëqyrës, përmirësimin e

proceseve të inspektimit dhe zbatimit, si dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale të BMP, duke garantuar një mbikëqyrje më efektive, të pavarur dhe transparente në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet ndërkombëtare të auditimit dhe dhënies së sigurisë.

Me fokus në cilësinë e auditimit, si kujdestarë të tarifave të mbledhura për të financuar përpjekjet tona, ne duhet të veprojmë në mënyrë sa më efektive dhe efikase të jetë e mundur duke kultivuar më tej një kulturë pune me integritet të lartë, bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet struktura e financimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike:



Rritja e qëndrueshme e burimeve është rezultat i rritjes së efektivitetit të administrimit të tarifave të mbledhura dhe efikasitetit operacionale, por edhe rezultat i reformave të rëndësishme të reflektuara në kuadrin ligjor dhe rregullator. Këto burime janë shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme dhe në rritje për të mbështetur aktivitetin mbikëqyrës, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe në forcimin e besimit në raportimin financiar.

3. Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2025

3.1. Funksionimi i komisioneve të ngritura pranë BMP

3.1.1 Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP) është krijuar në zbatim të nenit 17 dhe 18 të ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjorë dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe pikës IV/1/1 të VKM-së Nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, e ndryshuar. Ky komision ka për objekt të veprimtarisë organizimin dhe realizimin e testeve, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve për Auditues Ligjorë dhe Kontabilistë të Miratuar.

Anëtarët e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale, bazuar në ligjin nr. 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar, u miratuan nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike me Vendimin nr. 71 datë 12.11.2020 “Për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale”, Vendimin nr. 51, datë 23.08.2022 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike “Për emërimin e kryetarit të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale” dhe Vendimin nr. 15, datë 20.04.2023 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike “Për emërimin e anëtarit të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale”.

KPAP përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga BMP për një periudhë 4 (katër) vjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:

- a. kryetari nga Ministri i Financave;
- b. dy anëtarë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- c. një anëtar nga organizmat profesionalë apo Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- d. një anëtar nga profesori i fushës së universiteteve.

Përmes procesit të vlerësimit të kandidaturave për t'u përzgjedhur si anëtarë të KPAP-së, BMP përzgjedh dhe emëron kandidatët fitues të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nga organizmat profesionalë apo Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe nga profesori i fushës së universiteteve. Procesi i vlerësimit realizohet nga një komision “Ad-Hoc” nga struktura mbështetëse, që bën vlerësimin e aplikimeve dhe ia paraqet BMP për vendimarrje.

KPAP realizon veprimtarinë në zbatim të misionit të vet të përcaktuar nga ligji dhe nga aktet e tjera rregullatore, sikurse janë:

- Rregullorja Nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e Komisionit të provimeve të aftësive profesionale dhe të mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për AL dhe KM”, e ndryshuar;
- Rregullorja Nr. 6, datë 31.05.2018 “Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për AL dhe KM”, e ndryshuar.

KPAP miratoi kalendarin e datave të provimeve përfundimtare të aftësive profesionale për marrjen e titullit Kontabilist i Miratuar dhe Auditues Ligjor për sezonin e vitit 2025. Në sezonin e vitit 2025, u regjistruan gjithsej 268 kandidatë për marrjen e titullit KM dhe 83 kandidatë për marrjen e titullit AL.

Për vitin 2025, KPAP ka realizuar 24 mbledhje.

Në mënyrë të përmbledhur aktivitetet kryesore të realizuara nga KPAP, përgjatë vitit 2025, për organizimin e sezonit përkatës konsistojnë në miratimin dhe zbatimin e kalendarit të provimeve në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale për kandidatët për Kontabilist të Miratuar (KM) dhe Auditues Ligjor (AL).

KPAP koordinoi proceset bashkërisht me organizatën profesionale të audituesve ligjorë (IEKA) dhe sekretarinë teknike, duke përfshirë publikimin e informacionit për provimet, administrimin e dokumentacionit dhe verifikimin e kandidaturave. Marrjen e masave të karakterit teknik dhe administrativ për zhvillimin e provimeve në përputhje me kuadrin ligjor, duke garantuar kushte të barabarta për të gjithë kandidatët. U miratuan dhe u trajnuan personat e angazhuar në hartimin, mbikëqyrjen dhe korrigjimin e provimeve përfundimtare, si dhe u siguruan të gjitha kushtet logjistike për realizimin e procesit.

Në vijim të procesit, u zhvillua provimi i parë i datës 11.10.2025 në disiplinën “Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar”, në të cilën morën pjesë 174 kandidatë dhe u shpallën 58 fitues.

Pas publikimit të rezultateve në disiplinën e sipërcituar, nga ana e sekretarisë teknike u përcollën kërkesat për ankimin të cilat u trajtuan sipas procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator të sipërcituar.

Me Vendimin Nr. 21 datë 16.10.2025, KPAP vendosi lidhur me shtyrjen e procesit të provimeve duke filluar nga provimi i datës 18 Tetor 2025 e në vazhdim, deri në një datë të mëvonshme. Vijueshmëria e këtij procesi përbën një ndër prioritetet kryesore të BMP, me fokus në adresimin e shtyrjes së këtij procesi dhe ndërmarrjen e masave konkrete për të garantuar vazhdimësinë dhe zhvillimin e tij gjatë vitit 2026.

3.1.2 Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës

Në mbështetje të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, VKM-së nr. 786, datë 09.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, e ndryshuar, dhe në kuadër të përgjegjësisë që rrjedhin nga Rregullorja “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”, si edhe në vijimësi të Vendimit nr. 15 datë 21.05.2024 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës (KIDB) së Bordit të Mbikëqyrjes Publike” ka ri ngritur pranë tij këtë komision gjatë vitit 2025 me Vendimin nr. 38, datë 26.06.2025.

Aktualisht, ky komision përbëhet nga pesë anëtarë, një anëtar me formim juridik dhe katër profesionistë jo praktikues në fushën e auditimit, raportimit financiar dhe kontabilitetit, si edhe legjislacionit tatimor. Kjo përbërje garanton një balancë të përshtatshme ndërmjet ekspertizës ligjore dhe asaj profesionale, duke siguruar trajtim të pavarur dhe profesional të çështjeve që shqyrtohen nga ky komision.

Në përputhje me pikën 4 dhe 5 të nenit 5 të Rregullores “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”, KIDB konfirmon që në fillim të çdo procesi shqyrtimi për përcaktimin dhe propozimin e masave disiplinore, se çdo anëtar i caktuar për shqyrtimin e një rasti nuk ka lidhje ose interesa në çështjen që investigohet. Në rast të identifikimit të ndonjë konflikti, qoftë në fillim ose gjatë procesit të shqyrtimit, anëtari është i detyruar të tërhiqet menjëherë nga procesi i vendimmarrjes, duke ruajtur integritetin dhe besueshmërinë e veprimtarisë së KIDB.

Objekti i veprimtarisë së KIDB përfshin shqyrtimin e ankesave të paraqitura ndaj audituesve ligjorë, shoqërive të auditimit, organizatës profesionale të audituesve ligjorë (IEKA), si dhe subjekteve të tjera që bien nën fushën e mbikëqyrjes së BMP. Gjithashtu, Komisioni shqyrton rastet e shkeljeve të identifikuara në kuadër të kontrollit të sigurimit të cilësisë dhe të proceseve të mbikëqyrjes, si dhe çdo rast tjetër që, sipas rregullores, çon në nisjen e një procedure investigimi.

Nenet 10–16 dhe 18 të Rregullores “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore” përcaktojnë procedurat për nisjen, shqyrtimin dhe përfundimin e proceseve të investigimit nga BMP, duke rregulluar mënyrat e fillimit të procedurës, trajtimin e ankesave dhe informacioneve, zhvillimin e procesit të investigimit, si dhe vendimmarrjen përfundimtare, përfshirë mbylljen e çështjes ose propozimin e masave disiplinore.

Aktiviteti i këtij komisioni, gjatë vitit 2025 është fokusuar në shqyrtimin e çështjeve procedurale, analizën e ndryshimeve ligjore në funksion të përmirësimit procedural dhe rritjes së efektivitetit me qëllim përmirësimin e zbatimit të masave shtrënguese, si edhe trajtimin paraprak të ankesave.

Gjatë vitit 2025, KIDB zhvilloi gjithsej 25 mbledhje, të fokusuar në shqyrtimin e çështjeve procedurale, analizimin e kuadrit rregullator dhe trajtimin paraprak të ankesave.

Aktivitetet kryesore të KIDB gjatë vitit 2025 përfshijnë:

1. Shqyrtimi i ankesave dhe zhvillimi i dëgjësive

Gjatë periudhës në shqyrtim, Komisioni ka trajtuar dy ankesa të paraqitura nga subjekte dhe individë, duke ndjekur në mënyrë të plotë procedurat administrative në fuqi. Në kuadër të këtij procesi, janë zhvilluar seanca dëgjimore me palët e përfshira, është kryer analiza e dokumentacionit dhe provave të paraqitura, si dhe janë arritur konkluzione përfundimtare për secilin rast, duke i adresuar në përputhje me kompetencat për trajtim të mëtejshëm nga organizatat profesionale.

I gjithë procesi është zhvilluar në përputhje me parimet e transparencës, paanshmërisë dhe garantimit të së drejtës për t'u dëgjuar.

2. Përmirësimi i efektivitetit dhe proporcionalitetit të sistemit të sanksionimit në kuadër të hartimit të akteve nënligjore

Komisioni ka kontribuar në përmirësimin e kuadrit rregullator dhe forcimin e kapaciteteve institucionale përmes:

- Shqyrtimit të raportit të konsulentës ndërkombëtare J.V. Diggelen mbi mbështetjen teknike në kuadër të projektit SQARP të Bankës Botërore;
- Diskutimit dhe integritit të rekomandimeve të raportit të konsulentës në Rregulloren për investigimin dhe procedurat disiplinore, në kuadër të ndryshimeve të ligjit nr. 10091/2009 (në fuqi nga 30.01.2025);
- Diskutimit të projekt-rregullores dhe komenteve përkatëse për përmirësimin e procedurave të investigimit dhe marrjes së masave disiplinore.

3. Mbikëqyrja e cilësisë së auditimit

Shqyrtimin e pajtueshmërisë me ligjin 10091/2009, rregulloren “*Për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit*” dhe rregulloren “*Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore*” të raportit përmbledhës dhe vlerësimin në kuadër të procesit të kontrollit të sigurimit të cilësisë të realizuar gjatë 2025.

Gjatë periudhës në shqyrtim, veprimtaria e Komisionit është karakterizuar nga një fokus i qartë në forcimin e mbikëqyrjes dhe zbatimit të ligjit, nëpërmjet trajtimit në kohë dhe transparent të ankesave, angazhimit në rritjen e cilësisë së auditimit përmes analizës së raporteve të kontrollit të sigurimit të cilësisë, si edhe kontributit aktiv në përmirësimin e kuadrit rregullator, në përputhje me ndryshimet ligjore dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Kjo veprimtari ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të sistemit të mbikëqyrjes publike dhe në konsolidimin e besimit në profesionin e auditimit në Shqipëri.

Për periudhën e raportimit, pranë këtij komisioni nuk janë paraqitur raste të cilat përbëjnë sjellje të papajtueshme apo shkelje të dispozitave të ligjit për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, e për rrjedhojë nuk ka propozuar masa disiplinore ndaj subjekteve të mbikëqyrjes.

3.1.3 Komisioni Ligjor

Në zbatim të pikës IV/1/1 e VKM-së Nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, e ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë funksionimin e BMP, me Vendimin nr. 13 datë 08.05.2025 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Aktualisht, është ri ngritur në vijimësi Komisioni Ligjor i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i cili përbëhet nga 3 anëtarë specialistë të fushës.

Veprimtaria e Komisionit Ligjor konsiston në shqyrtimin dhe dhënien e opinionëve ligjor mbi:

- Projekt-rregulloret, projekt-vendimet, aktet nënligjore dhe shqyrtimin e çështjeve të tjera në funksion të vendim marrjes së Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- Çështjet e shqyrtuara nga Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së BMP (KIDB), kur natyra e tyre kërkon njohuri të tilla, të cilat e kufizojnë strukturën mbështetëse që merret me çështje ligjore për të dhënë një opinion të plotë, sipas rregullores së investigimit;
- Propozimet e KIDB dhe relacioneve përkatëse mbi masat disiplinore për subjektet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që paraqiten për miratim pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- Ofrimin e këshillimit ligjor për komisionet dhe grupet e punës të ngritura pranë BMP;
- Propozimet e Inspektorëve të Lartë për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë dhe relacioneve përkatëse mbi vlerësimin me notë dhe masat disiplinore përkatëse në përfundim të kontrollit të sigurimit të cilësisë, që paraqiten për miratim pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- Çështje të ndryshme të parashikuara nga legjislacioni në Republikën e Shqipërisë që kanë efekt mbi pajtueshmërinë e veprimtarisë së BMP gjatë zbatimit të kuadrit ligjor për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në vijim të veprimtarisë së tij, Komisioni Ligjor gjatë vitit 2025 ka zhvilluar 12 mbledhje në total dhe ka dhënë 8 opinionë ligjore, duke ushtruar funksionin e tij këshillimor për çështje ligjore dhe rregullatore që lidhen me funksionimin e veprimtarisë së BMP.

Komisioni ka dhënë opinion ligjor lidhur me disa shtesa dhe ndryshime në Statutin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si dhe ka shqyrtuar hartimin e akteve nënligjore në kuadër të ndryshimeve në ligjin për auditimin, konkretisht:

- Rregullore “Për procedurat dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”;
- Rregullore “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”;
- Rregullore “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të

auditimit të angazhuar në auditimin e njësisë ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik”;

- Rregullore “*Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrit publik*”;
- Rregullore “*Për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit*”.

Ky komision ka shqyrtuar dhe dhënë opinionet përkatëse ligjore mbi raportet përmbledhëse të kontrollit të cilësisë të realizuar pranë audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, si edhe masave të propozuara nga inspektorët e lartë të kontrollit të sigurimit të cilësisë, me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes së BMP në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

3.1.4 Komisioni i Rishikimit

Në mbështetje të ligjit 10091 datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*”, i ndryshuar dhe në kuadër të përmbushjes së përgjegjësisë që rrjedhin nga rregullorja Nr. 2, datë 20.02.2018 “*Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar*”, e ndryshuar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ngriti pranë tij Komisionin e Rishikimit, me Vendimin nr. 21, datë 11.05.2023, i cili pësoi ndryshime sipas Vendimit nr. 17, datë 21.05.2024 të BMP.

Komisioni i Rishikimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë profesionistë, ndër të cilët 2 (dy) janë juristë dhe 3 (tre) të përzgjedhur nga profesionistë të fushës së kontabilitetit, auditimit, fiskale, e të menaxhimit, në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregulloren nr. 2/2018 e ndryshuar të BMP.

Komisioni i Rishikimit, ka kompetencat si më poshtë:

- të verifikojë hartuesit dhe korigjuesit, që propozohen nga KPAP në përputhje me këtë rregullore;
- të verifikojë rishikuesit e cilësisë së hartimit të tezës që propozohen nga KPAP në përputhje me këtë rregullore që do të kontrollojnë cilësinë e fondit të pyetjeve të përgatitura nga hartuesit;
- të verifikojë ri korigjuesit që propozohen nga KPAP në përputhje me këtë rregullore, që do të angazhohen për të rishikuar rastet e fletoreve të korigjuara për të gjitha diferencat mbi 5% të pikëve, që rrjedhin nga procesi i korigjimit të dy grupeve paralele të korigjuesve.

Përgjatë vitit 2025, Komisioni i Rishikimit ka zhvilluar 7 mbledhje dhe ka marrë 9 vendime. Çështjet kryesore të trajtuara prej tij, përgjatë vitit 2025, janë:

1. Verifikimi dhe miratimi i hartuesve, rishikuesit të cilësisë së hartimit të tezës, korigjuesve dhe ri korigjuesit e provimit të parë të datës 11.10.2025, në disiplinën “*Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar*”;
2. Verifikimi dhe miratimi i hartuesve dhe rishikuesit të cilësisë së hartimit të tezës të provimit të dytë të datës 18.10.2025, në disiplinën “*Zbatimi në praktikë i*

legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare”;

3. Verifikimi dhe miratimi i hartuesve dhe rishikuesit të cilësisë së hartimit të tezës të provimit të tretë të datës 25.10.2025, në disiplinën “Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”.

4. Forcimi i Cilësisë së Auditimit: Mbikëqyrja, Zhvillimi Profesional dhe Treguesit e Cilësisë

4.1. Cilësia në auditim

Cilësia e auditimit është thelbësore për ruajtjen e besimit në tregjet financiare, duke u ofruar investitorëve, rregullatorëve dhe palëve të interesuara besim në saktësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar. Roli ynë, si autoriteti i pavarur mbikëqyrës i profesionit të auditimit, është të mbështesim dhe përmirësojmë cilësinë e auditimit, duke siguruar që pasqyrat financiare të paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të njësive ekonomike. Auditimet e cilësisë së lartë zbusin rrezikun e keq deklarimeve, mashtrimeve dhe falimentimeve të njësive ekonomike, duke kontribuar në një sistem financiar të shëndoshë e të qëndrueshëm.

Një funksion kyç i aktiviteteve tona mbikëqyrëse është vlerësimi i vazhdueshëm i firmave të auditimit përmes inspektimeve, kontrolleve dhe, kur është e nevojshme, marrjes së masave shtrënguese. Duke vlerësuar përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator, standardet e auditimit dhe kërkesat etike ne identifikojmë fushat për përmirësim dhe nxitjen e praktikave më të mira të auditimit. Mbrojtja e pavarësisë së audituesve mbetet një prioritet thelbësor, duke siguruar që audituesit të përmbushin përgjegjësitë e tyre për interesin publik të pa ndikuar nga interesi i biznesit. Kjo është veçanërisht kritike në rastet kur shoqëritë ofrojnë shërbime auditimi dhe jo auditimi, të cilat mund të paraqesin konflikte të mundshme interesi.

Angazhimi ynë për cilësinë e auditimit shtrihet përtej mbikëqyrjes; ne zhvillojmë kapacitetet tona për të qenë në të njëjtin hap me rreziqet në zhvillim, përparimet teknologjike dhe dinamikën e tregut. Duke bashkëpunuar me partnerët rregullatorë ndërkombëtarë, me organizatat ndërkombëtare që hartojnë e publikojnë standardet profesionale të auditimit e raportimit financiar, ne promovojmë konsistencën globale dhe praktikatat më të mira në mbikëqyrjen e auditimit.

Nëpërmjet zbatimit të programeve tona të kontrollit të sigurimit të cilësisë, BMP kontribuon në forcimin e besueshmërisë së raportimit financiar dhe përforcimin e besimit të publikut në auditimin dhe raportimin financiar.

4.2. Kontrolli i sigurimit të cilësisë dhe forcimi i kapaciteteve

BMP ka zhvilluar një strategji të kontrollit dhe monitorimit të shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë e cila bazohet në kontrollin e drejtpërdrejtë (me inspektime të vazhdueshme) për shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë të NjEIP, si dhe në monitorimin (mbikëqyrjen) e shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë të mesëm dhe të vegjël. Çdo vit, me të dhënat e mbledhura nëpërmjet raportimit të misioneve të angazhimeve të auditimit, inspektorët e strukturës mbështetëse plotësojnë matricën e rrezikut që shërben si bazë për realizimin e procesit të kontrollit dhe monitorimi bazohet në një analizë rrisht, duke e fokusuar veprimtarinë e BMP në subjektet që paraqesin rrisht më të lartë.

Gjatë vitit 2025, në drejtim të përmbushjes së misionit të BMP-së është ndërmarrë realizimi i kontrolleve të cilësisë në 45 subjekte shoqëri audituese/auditues ligjorë dhe janë kontrolluar 45 angazhime të auditimit ligjor të realizuara nga këto subjekte.

Gjatë procesit të inspektimeve, BMP i kushton rëndësi të madhe transparencës dhe diskutimit të hapur të gjetjeve dhe fushave të përmirësimit me palët e përfshira në proces, duke ritheksuar se fokusi i BMP është identifikimi i çështjeve me rrisht më të lartë për interesin publik dhe përmirësimi i cilësisë së punës audituese.

Për një kuptim më të qartë të rezultateve të vitit 2025 analiza është bërë përmes grafikëve që paraqesin trendin e rezultateve në një shtrirje kohore për vitet 2018 – 2025. Gjithashtu, kemi paraqitur një grafik të fushave të përmirësimit të identifikuara gjatë procesit të kontrollit të ndjekjes së mëtejshme të zbatimit të planit të veprimt. Një sfidë mbetet rritja e kapaciteteve e audituesve ligjorë praktikues të vetëm, si edhe të personelit mbështetës që ato përdorin në realizimin e angazhimeve të ofrimit të sigurisë (auditimit dhe shërbimeve të tjera të sigurisë).

Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka krijuar një eksperiencë të çmuar gjatë kontrolleve të cilësisë përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, e cila ka rritur kapacitetet teknike dhe efektivitetin e stafit të BMP. Nga ana tjetër, kjo eksperiencë transferohet gjatë procesit të inspektimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë edhe tek shoqëria e auditimit/audituesit ligjor duke u përkthyer si një proces zhvillues profesional dhe përmirësues në aspektin e cilësisë së punës për të gjitha palët pjesëmarrëse në proces.

4.2.1 Rritja e kapaciteteve të strukturës mbështetëse në kuadër të mbikëqyrjes të cilësisë së auditimit

Për realizimin e funksioneve mbikëqyrëse BMP mbështetet në aftësitë dhe kapacitetin e strukturës mbështetëse për të realizuar kontrollin e sigurimit të cilësisë pranë subjekteve të mbikëqyrura. Kjo nënkupton investimin në zhvillimin profesional, nxitjen dhe promovimin e kulturës së rritjes së njohurive në vendin e punës. Kjo na vjen në ndihmë për rritjen e produktivitetit dhe bashkëpunimit të punonjësve duke krijuar një mjedis që ofron fleksibilitet, autonomi dhe mundësi ndërveprimi midis tyre Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe forcimi i kapaciteteve institucionale janë shtylla të rëndësishme për një sistem efektiv të

mbikëqyrjes së cilësisë së auditimit. Theksi në mbrojtjen e interesit të publikut dhe investitorëve nëpërmjet cilësisë së auditimit dhe raportimit financiar vjen duke u rritur, e në të njëjtën kohë zhvillimi i profesionit dhe mënyrave të përdorimit të teknologjisë në profesion përbën një sfidë të vazhdueshme për rregullatorin kur bëhet fjalë për zhvillimin e kapaciteteve dhe ruajtjen e ritmit për një mbikëqyrje sa më efektive.

Pjesëmarrja e strukturës mbështetëse të BMP në aktivitete trajnuese, seminare dhe konferenca, gjatë vitit 2025, ka qenë intensive dhe e orientuar drejt çështjeve më aktuale të profesionit. Në kuadër të anëtarësisë në Forumin Ndërkombëtar të Rregullatorëve të Pavarur (IFIAR), janë trajtuar dhe diskutuar një sërë tematikash të rëndësishme, të cilat kanë kontribuar në thellimin e njohurive dhe përmirësimin e praktikave të inspektimit, si më poshtë:

- Shpalosjet e lidhura me klimën – njohuri dhe praktika nga Autoriteti i Tregjeve Financiare të Zelandës së Re;
- Përditësime mbi dhënien e sigurisë për qëndrueshmërinë nga Autoritetet Rregullatore të Japonisë dhe Malajzisë;
- Përdorimi në zhvillim i Inteligjencës Artificiale në auditim dhe mbikëqyrje;
- Zbatimi i SNMC 1 – Çështje dhe problematika të paraqitura nga anëtarët e IFIAR;
- Anketa e IFIAR mbi gjetjet e inspektimeve – përditësime të modeleve dhe sesioni pyetje-përgjigje;
- Takime dhe sesione plenare me rrjetet ndërkombëtare të auditimit (PëC, KPMG, Deloitte, BDO, EY) në kuadër të IFIAR, me fokus shkëmbimin e praktikave dhe zhvillimeve profesionale;
- Zbatimi i SNMC 1- Inspektimi i burimeve teknologjike të shoqërive të auditimit;
- Raste studimi - Inspektimi i industrive të prekura nga kriza e pasurive të paluajtshme si dhe Inspektimi i Auditimeve të Sigurimeve;
- Qasjet e avancuara të inspektimit, të bazuara në risk, si dhe teknikat për auditimet e IT dhe sektorët specifikë;
- Dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimet përkatëse ndërkombëtare;
- Identifikimi i mashtrimit në pasqyrat financiare dhe trajtimi i sfidave gjatë inspektimit;
- Aspekte teknike të auditimit, si kampionimi (SNA 530) dhe ndikimi i SNA 600 të rishikuar në auditimet e grupeve;
- Forcimi i mbikëqyrjes së auditimit dhe rolin e komiteteve të auditimit;
- Menaxhimi i mosdakordësive me subjektet e inspektuara dhe zhvillimin e aftësive të komunikimit (soft skills);
- Iniciativat për përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe analiza praktike mbi inspektimin e të ardhurave.

Njëkohësisht, një kontribut i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve sigurohet në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Qendrën për Reformat në Raportimin Financiar (CFRR) të Bankës Botërore, në kuadër të Programit të Përmirësimit të Kontabilitetit, Auditimit dhe Raportimit të Qëndrueshmërisë (EAASURE), si dhe Projektit për Forcimin e Cilësisë së

Auditimit dhe Raportimit Financiar (SQARP). Nga këto projekte janë zhvilluar trajnime me fokus në raportimin e qëndrueshmërisë dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare përkatëse, ku janë trajtuar ndër të tjera:

- Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Qëndrueshmërisë (ISSB)-Trajtimi i Standardeve për adresimin dhe avancimin e çështjeve kyçe në raportimin e qëndrueshmërisë, përfshirë hyrjen në standardet globale dhe aspektet e ndërveprueshmërisë;
- Kërkesat për shpalesje sipas industrive përkatëse në kuadër të raportimit të qëndrueshmërisë;
- Adaptimi rregullator i Standardeve ISSB dhe implikimet për kuadrin e raportimit;
- Trajtimi dhe raportimi i emetimeve të financuara në kontekstin e qëndrueshmërisë;
- Avancimi i raportimit të qëndrueshmërisë për NVM-të, me fokus në kuptimin e Standardit Vullnetar të Raportimit të Qëndrueshmërisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (VSME), përmbajtjen dhe fushën e zbatimit të tij.

Në vijim të zhvillimeve ndërkombëtare, stafi i BMP ka marrë pjesë edhe në trajnime të organizuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB), të fokusuara në Standardi Ndërkombëtar për Dhënie të Sigurisë të Raportimit të Qëndrueshmërisë (ISSA) 5000, duke përfshirë:

- Parimet dhe konceptet themelore të angazhimeve të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;
- Planifikimin e angazhimeve, vlerësimin e rrezikut dhe përgjigjen ndaj tij;
- Konkluzionet dhe raportimi mbi konfirmimin e angazhimeve të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

Gjithashtu, në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit më të madh dhe shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve mbikëqyrëse, janë zhvilluar një sërë trajnimesh të organizuara nga Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri, Këshilli i Evropës, në bashkëpunim me Agjencinë e Intelgjencës Financiare për çështje që lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për parandalimin e korrupsionit parandalimin, parandalimit të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit dhe efektiviteti i sektorit të zbatimit të ligjit dhe drejtësisë penale në luftën kundër krimit ekonomik si edhe ndikimit të elementëve kriminalë ndaj institucioneve jo-financiare, duke theksuar masat parandaluese dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit.

4.2.2 Forcimi i Cilësisë së Auditimit në Shqipëri: Reformat dhe bashkëpunimet për transparencë dhe integritet

Në datat 9 -10 Dhjetor 2025, u organizuar forumi i katërt i Autoriteteve të Mbikëqyrjes Publike (Forum i POB), në kuadër të dy programeve kryesore të Qendrës së Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR) : Programi Rruga drejt Evropës për Reformën e Kontabilitetit dhe Forcimin e Institucioneve për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (REPARIS për NVM-të) dhe Programi Përmirësimi i Raportimit të Kontabilitetit, Auditimit dhe Qëndrueshmërisë (EASASURE). Forumi POB u krijua në maj 2023 në kuadër të REPARIS

për NVM-të, me qëllim përmirësimin e cilësisë së auditimit në vendet e Ballkanit Perëndimor përmes të mësuarit, shkëmbimit të përvojës dhe bashkëpunimit rajonal. Ky forum shërben për ndarjen e njohurive dhe përvojës ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e mbikëqyrjes publike dhe sigurimit të cilësisë, si edhe përfshin autoritetet kompetente nga 11 vende pjesëmarrëse: Shqipëria, Armenia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Ukraina.

Në këtë aktivitet u theksua se Shqipëria ka arritur një moment të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit të mbikëqyrjes së auditimit, duke kaluar nga një fazë reformash teknike drejt njohjes ndërkombëtare, veçanërisht me pranimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) si vëzhgues në nivel plenar në CEAOB. Ky zhvillim përfaqëson një dëshmi të pjekurisë institucionale, pavarësisht dhe besueshmërisë së sistemit shqiptar të mbikëqyrjes.

Progresi i arritur është rezultat i reformave të qëndrueshme ligjore dhe institucionale, si dhe i mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht Banka Botërore. BMP ka evoluar në një autoritet modern mbikëqyrës, duke zbatuar inspektime të bazuara në rrezik, mekanizma disiplinorë dhe standarde të harmonizuara me praktikën evropiane dhe ndërkombëtare.

Ndikimi i reformave është reflektuar edhe në tregun e auditimit, ku rritja e tarifave dhe ulja e opinionëve të modifikuara për subjektet me interes publik tregojnë përmirësim të cilësisë së auditimit dhe disiplinës në raportimin financiar. Ky zhvillim konfirmon kalimin nga një treg i orientuar nga kostoja drejt një modeli të bazuar në cilësi dhe përgjegjësi profesionale.

Gjithashtu, gjatë diskutimeve lidhur me ndikimin e këtyre reformave në 15 vitet e fundit u nënvizua se këto aktivitete kanë kontribuar në transformimin e mbikëqyrjes në një funksion modern rregullator. Kalimi nga një model minimal në një autoritet plotësisht funksional ka sjellë pavarësi më të lartë operacionale, staf të dedikuar dhe rritje të numrit të kontrolleve të realizuara, si edhe aktiviteteve të tjera mbikëqyrëse.

Ndikimi në tregun e auditimit:

- Tregu ka shënuar rritje të vazhdueshme dhe ka dyfishuar vlerën ndër vite
- Rritja e tarifave profesionale, duke reflektuar se “auditimi i lirë” nuk është më një opsion
- Investime më të mëdha në cilësi, trajnim dhe përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe standardet profesionale.

Kjo ka krijuar një cikël pozitiv: mbikëqyrje më e mirë → cilësi më e lartë → auditime me vlerë më të madhe → praktika më të qëndrueshme → më shumë burime për mbikëqyrje, duke dëshmuar një rritje të efektivitetit dhe efikasitetit të mbikëqyrjes së realizuar nga BMP.

4.2.3 Konkurrenca në tregun e auditimit

Tregu i auditimit në Shqipëri është i përbërë nga 153 auditues ligjorë që e ushtrojnë aktivitetin si person fizik dhe 79 shoqëri auditimi dhe 28 auditues ligjorë të punësuar pranë shoqërive të auditimit, me një total prej 260 auditues ligjorë të regjistruar në fund të vitit 2025.




Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit ndërmarrin rreth 3841 auditime ligjore në vit referuar të dhënave për angazhimet e realizuar në vitin 2025. Qarkullimi i përgjithshëm i vlerësuar nga të dhënat e disponueshme pranë BMP është 1,604 milionë Lekë ose rreth 16,57 milionë EURO, me një rritje prej 9.8 përqind nga viti i mëparshëm. Audituesit ligjorë kanë realizuar një qarkullim vjetor prej rreth 30% të auditimeve për pasqyrat financiare të

vitit 2025, ndërsa shoqëritë audituese kanë realizuar një qarkullim prej rreth 70%.

Gjatë pesë viteve të fundit, të ardhurat e realizuara për shërbimet e auditimit kanë qenë në rritje si për shoqëritë e auditimit, ashtu edhe për audituesit ligjorë. Ndryshimet në formën ligjore të ushtrimit të profesionit nga person fizik në shoqëri auditimi, gjatë vitit 2025.

Në mënyrë të detajuar, të ardhurat e realizuara nga shërbimet e auditimit përkatësisht prej shoqërive të auditimit dhe audituesve ligjorë gjatë periudhës 2020 - 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:



Ecuria e tregut për periudhën 2018-2025 sipas të ardhurave të realizuara nga shërbimet e auditimit paraqitet si në vijim:





Tabela në vijim jep një informacion mbi të ardhurat e realizuara nga shërbimet e auditimit të ndara sipas natyrës së njësisë ekonomike, përkatësisht për honorarët e njësive me interes publik dhe honorarët e njësive jo me interes publik gjatë periudhës 2020 – 2025.



Shërbimet e tjera të realizuara nga audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit zënë një peshë të konsiderueshme në të ardhurat e tyre. Kështu, nga të dhënat e disponueshme për vitin 2025 rezulton që audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit kanë realizuar të ardhura nga shërbime të tjera në një vlerë prej rreth 1,464 milion Lekë ose rreth 15 milionë EURO.



Ashtu si në angazhimet e auditimit shoqëritë audituese kanë volumin më të lartë me rreth 62% e të ardhurave në dhënien e shërbimeve të tjera, Shërbimet e tjera përfshijnë: angazhime të dhënies së sigurisë si rritje kapitali, transformim, bashkim, ndarje, vlerësim aktivesh, ekspertiza gjyqate dhe të ngjashme; angazhime të rishikimit të

informacioneve financiare historike, mbajtje kontabiliteti, përgatitje e pasqyrave financiare, konsulentë dhe të tjera të ngjashme.


4.2.4 Renditja e subjekteve

Në përputhje me rregulloren “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit të angazhuar në auditimin e njësive ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik” dhe rregulloren “Për procedurat dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, brenda datës 30 Janar të çdo viti, audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit raportojnë pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, të dhënat mbi angazhimet e auditimit në njësitë ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik dhe shërbimet e tjera. Kështu, në vijim të përpunimit të informacionit nga struktura mbështetëse më poshtë kemi shpalosur në rend zbritës klasifikimin e shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë, sipas honorarëve të faturuara për auditimet e njësive ekonomike me interes publik (NjEIP) (Tab.1) dhe sipas totalit të honorarëve të faturuara për shërbimet e auditimit nga shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë (Tab.2), të kryera gjatë vitit 2025.

Tabela 1 – Renditja e shoqërive të auditimit sipas honorarëve të faturuara për auditimet e njësive ekonomike me interes publik (NjEIP)



Tabela 2 – Renditja e shoqërive të auditimit sipas honorarëve të faturuara për shërbimet e auditimit



4.3. Mbikëqyrja për sigurimin e cilësisë

Objektivi i kontroleve për sigurimin e cilësisë së auditimit është të sigurojë dhe promovojë përmirësimin në cilësinë e auditimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe standardet profesionale të auditimit. Kontrolli i cilësisë së auditimit vlerëson cilësinë e punës, procedurave dhe politikave të audituesve në angazhimet që ata ndërmarrin, veçanërisht pranë njësive ekonomike me interes publik (NJEIP).

Shoqëritë e auditimit dhe angazhimet e auditimit të shqyrtuara janë përzgjedhur bazuar në vlerësimin e riskut sipas metodologjisë së sipërpërmendur, si një risi e cila mbështetet në kriteret ligjore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025 u planifikua kalendari i punës për vijimin e realizimit të inspektimeve të audituesve ligjorë të aprovuara nga BMP. Struktura mbështetëse e BMP, zhvilloi kontrole në vend dhe nga zyra për 45 subjekteve të licencuara si auditues ligjor apo shoqëri audituese. Këto inspektime u zhvilluan bazuar në rregulloren 7/2018, “Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor”, e ndryshuar.

Mangësitë e identifikuar dhe të raportuara gjatë procesit të kontrollit të sigurimit të cilësisë, edhe pse paraqesin një vlerësim nga BMP, duke qenë një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar cilësinë e auditimit, duhet të analizohen bashkë me tregues të tjerë sasiorë dhe cilësorë të cilësisë së auditimit.

BMP do të vendosë një theks më të madh në pritshmërinë që subjektet e kontrolluara të ndërmarrin plane të veprimit për të korigjuar mangësitë ose gjetjet e identifikuar nga kontrolli i cilësisë në sistemet e tyre të kontrollit të brendshëm, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të auditimit.


Elementët kryesorë të vlerësuar në kontrollet e sigurimit të cilësisë të realizuar nga BMP, janë cilësia e dokumentacionit të angazhimit të auditimit me qëllim vlerësimin e zbatimit të kërkesave të sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe përputhja me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë, si dhe kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës për Profesionistët Kontabël BSNEPK, sikurse vlerësimi i pajtueshmërisë me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Analiza në vijim siguron një informacion historik dhe sasior në lidhje me rezultatet e kontrollit të sigurimit të cilësisë të realizuar nga BMP, për periudhën 2018 – 2025, si një mjet për të identifikuar tendencat e përgjithshme në fushat e gjetjeve. Ky informacion nuk mat në mënyrë empirike ndryshimet në cilësinë e auditimit dhe as nuk vlerëson shkallën e gjetjeve të rëndësishme individuale të identifikuar në inspektimet individuale pranë shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë. Është e rëndësishme të theksohet se gjetjet nga një inspektim i një angazhimi auditimi nuk tregojnë domosdoshmërisht se pasqyrat financiare të audituara përmbajnë anomali materiale për shkak të gabimit apo mashtrimit. Përsëritja dhe niveli i gjetjeve të pasqyruara në analizën që vijon, reflektojnë një realitet të paqëndrueshëm në cilësinë e kryerjes së auditimit dhe domosdoshmërinë për të shtuar fokusin në përmirësimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të cilësisë së auditimit.

Viti i kontrollit	2018	2019	2021	2022	2023	2024	2025
Natyrë e gjetjes							
Përshtatja me legjislacionin vendas	2	4	10	1	11	7	
Mungesë/Plotësia e Manuali i KC	3	6	9	3	13	22	98
Zbatimi i politikave dhe procedurave të MKC / Kërkesave të SNKC1/SNMC	7	10	10	3	5	47	30
Metodologjia e Auditimit	2	7	10	4	11	34	38
Mungesa e Programit të Kompjuterizuar	3	9	10	6	14	5	42

Numri i gjetjeve

Në grafikun e mëposhtëm evidentohet se ka një prirje në rënie të mesatares së gjetjeve në nivel të sistemit të kontrollit të cilësisë, pavarësisht se në vlerë absolute identifikohet një rritje për shkak të dyfishit të numrit të kontrolleve të realizuara gjatë 2025, në krahasim me vitin 2024, por edhe vitet e mëparshme. Ndër mangësitë e identifikuara pothuaj në të gjitha rastet është mungesa e programit të informatizuar për kryerjen e auditimit e për rrjedhojë mangësi në mbledhjen/arkivimin e dosjes përfundimtare të auditimit.



Përsa i përket tranzicionit nga zbatimi i standardit të kontrollit të cilësisë 1 (SNKC1), i bazuar në rregulla që përcaktonin politikat dhe procedurat që duhet të zbatohen nga praktikuesit në sigurimin e cilësisë, në një sistem të brendshëm të kontrollit të sigurimit të cilësisë të bazuar në rrezik, sikurse kërkohet nga standardet e menaxhimit të cilësisë (SNMC 1 dhe SNMC2).

Gjatë mbikëqyrjes së realizuar në vitet 2024 – 2025, janë identifikuar vështirësi nga ana praktikuesve lidhur me:

- përcaktimin e objektivave të cilësisë për të gjithë elementët e menaxhimit të cilësisë, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve për arritjen e këtyre objektivave dhe hartimin/zbatimin e reagimeve për të adresuar e rreziqet e cilësisë të identifikuara në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Cilësisë 1 (SNMC 1);
- përcaktimin e kriterëve të angazhimeve të auditimit që duhet t'i nënshtrohen rishikimit të kontrollit të cilësisë në nivel të angazhimit në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Cilësisë 2 (SNMC 2);
- përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojë rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit, çështjet, shtrirjen dhe formën që duhet të përmbajë raporti i rishikuesit të kontrollit të cilësisë së angazhimit (SNMC 2);
- mbledhjen, arkivimin dhe ruajtjen e dosjes së angazhimit;
- monitorimin e sistemit të kontrollit të cilësisë të jetë në përputhje me kërkesat SNMC 1 duke përfshirë kriteret për përcaktimin e monitoruesit nëse nuk mund të realizohet nga burimet e brendshme e audituesit ligjor;
- dokumentimin e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë.


Në nivel të kontrollit të angazhimeve të auditimit, mangësitë e identifikuara tregojnë se sfidat kryesore vazhdojnë të lidhen me nivelin dhe cilësinë e dokumentimit të proceseve të auditimit, veçanërisht në fazat kritike të planifikimit, vlerësimin të rrezikut dhe reagimit ndaj rreziqeve të identifikuara.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i identifikuar lidhet me forcimin e proceseve të kontrollit të cilësisë së angazhimit, në veçanti në lidhje me dokumentimin e përfshirjes dhe konkluzioneve të rishikuesit të kontrollit të cilësisë. Mungesa e dokumentimit të duhur në këtë drejtim kufizon gjurmueshmërinë e procesit të rishikimit dhe transparencën mbi mënyrën se si janë adresuar çështjet me rëndësi gjatë angazhimit.

Në disa raste janë identifikuar gjithashtu mangësi në dokumentimin e komunikimit me drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, si dhe në procedurat e kryera në lidhje me vlerësimin e vijimësisë së aktivitetit. Dokumentimi i këtyre proceseve është thelbësor dhe është një tregues se çështjet me rëndësi janë diskutuar dhe vlerësuar në mënyrën dhe kohën e duhur gjatë procesit të auditimit.

Në përfundim, vazhdojnë të evidentohen mangësi në menaxhimin dhe arkivimin e dokumentacionit të auditimit, të cilat ndikojnë në aksesueshmërinë dhe ruajtjen e evidencave të punës audituese. Sistemet e strukturuar të arkivimit janë të rëndësishme për të siguruar integritetin e dosjes së auditimit dhe për të mundësuar rishikime të mëvonshme efektive.


Në vijim është paraqitur analiza e mesatares së gjetjeve për angazhime të kontrolluara, ku identifikohet një prirje e lehtë në rritje e ndikuar nga numri i angazhimeve të kontrolluara gjatë vitit 2025.




Natyrë e gjetjeve në nivel të angazhimi të auditimit 2018- 2025
Testimi i mjedisit të Kontrollit të Brendshëm
Transaksionet me palët e lidhura (Kontrollet dhe testimet)
Vijimësia
Procedurat e identifikimit të mashtrimit
Plani i auditimit në përgjigje të rreziqeve të identifikuar
Përdorimi i ekspertëve / specialistëve
Vlerësimi i rreziqeve për shkak të gabimit dhe mashtrimit

Natyrë e gjetjeve në nivel të angazhimi të auditimit 2018- 2025
Njohja e të ardhurave
Procedurat e inventarit
Përshtatshmëria e paraqitjes së pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese
Evidenca e Auditimit dhe Dokumentimi
Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen (Letra e Përfaqësimit + Letra e Drejtimit)
Praktikat më të mira: Listë kontrolli dhe listë kontrolli për shpalosjen e shënimeve shpjeguese

Mos pajtueshmëritë me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator kanë një rënie të ndjeshme, në totalin e numrit të dispozitave, megjithatë mos pajtueshmëria me nenin 38 përsa i përket sistemeve të dhënies së sigurisë që realizohet nga praktikuesit, mbetet ende një fushë për t'u përmirësuar, kryesisht në caktimin e rishikuesit të kontrollit të cilësisë së angazhimit dhe zbatimit të kërkesave të SNMC, si edhe në hartimin dhe publikimin e raportit të transparencës në përputhje me nenin 45 të ligjit për auditimin.



Gjithashtu në grafikun e mëposhtëm paraqitet edhe ecuria përkatëse e mesatares së gjetjeve që përbëjnë rrethana për mos pajtueshmëri me ligjin dhe rregulloret:



Çështjet e identifikuara në kryerjen e bashkë-auditimeve:

Mungesa në nivel politikash dhe procedurash në rastet e bashkë auditimeve 2018 - 2025
Mungesa e përcaktimit të rishikuesit të KC jashtë ekipit të angazhimit
Asemblimi, arkivimi dhe ruajtja e dosjes së angazhimit
Vlerësimi i riskut gjatë procedurave të pranimit / vazhimit
Komunikimi me audituesin paraardhës
Drejtimi, mbikëqyrja, kryerja e angazhimit
-Formalizimi i kontratave të bashkëpunimit
-Ndarja e fushave të përgjegjësisë
Përcaktimi i rishikuesit përgjatë kryerjes të angazhimit të auditimit
Komunikimi ndërmjet anëtarëve të grupit të auditimit
Konsultimi

4.4. Kontrolli i sigurimit të cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik -

Në kuadër të forcimit të mbikëqyrjes së profesionit të auditimit dhe rritjes së cilësisë së auditimeve ligjore, gjatë vitit 2025 Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) zbatoi për herë të parë në mënyrë të strukturuar delegimin e kontrollit të cilësisë për auditimet e njësisve jo me interes publik tek organizata profesionale e audituesve ligjorë (IEKA), në përputhje me Vendimin nr. 1, datë 29.01.2025 . Ky delegim u mbështet në një kuadër të qartë ligjor dhe rregullator, duke ruajtur rolin mbikëqyrës të BMP dhe duke siguruar që procesi të realizohej në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Delegimi u shtri për periudhën nga 7 shkurt deri më 15 tetor 2025 dhe synoi vlerësimin e cilësisë së dokumentacionit të angazhimeve të auditimit, si dhe nivelin e përputhshmërisë së tyre me standardet profesionale, kërkesat etike dhe kuadrin ligjor. Në këtë kuadër, IEKA u angazhua të sigurojë kapacitetet e nevojshme profesionale, pavarësinë dhe integritetin e procesit, si dhe zbatimin e një metodologjie të standardizuar kontrolli, të bazuar në analizën e riskut dhe përzgjedhjen e angazhimeve për inspektim.

Procesi i kontrollit të cilësisë u realizua përmes një qasjeje të strukturuar, që përfshiu fazën e para-inspektimit, realizimin e inspektimeve dhe fazën e raportimit. Inspektimet u mbështetën në shqyrtimin e dokumentacionit të dosjeve të auditimit, vlerësimin e sistemeve të brendshme

të kontrollit të cilësisë dhe testimin e përputhshmërisë me standardet kryesore të auditimit. Procesi i raportimit u zhvillua në disa etapa, duke përfshirë komunikimin e gjetjeve paraprake me subjektet e kontrolluara, marrjen e komenteve dhe angazhimeve për përmirësim, si dhe finalizimin e raporteve përfundimtare të shoqëruara me plane veprimi për adresimin e mangësive të identifikuara .

Realizimi i kontrollit të sigurimit të cilësisë në subjektet e deleguara tregon një mbulim të gjerë të tregut të auditimit për njësitë jo me interes publik dhe një angazhim të konsiderueshëm institucional për forcimin e cilësisë së auditimit.

Rezultatet e kontrollit të cilësisë evidentuan një sërë çështjesh të rëndësishme, si në nivel të sistemeve të kontrollit të cilësisë, ashtu edhe në nivel të angazhimeve individuale të auditimit. Në nivel sistemi, u konstatuan mangësi në përditësimin dhe zbatimin e manualeve të kontrollit të cilësisë në përputhje me standardet më të fundit ndërkombëtare (SNMC1 dhe SNMC2), si dhe mungesë e sistemeve të informatizuara për dokumentimin dhe arkivimin e dosjeve të auditimit. Gjithashtu, në shumë raste u identifikua një formalizim i pamjaftueshëm i procedurave dhe mekanizmave të monitorimit të cilësisë .


Në nivel të angazhimeve të auditimit, gjetjet kryesore lidhen me dokumentimin e pamjaftueshëm të evidencës së auditimit, mangësi në zbatimin e procedurave kyçe sipas standardeve ndërkombëtare (si vlerësimi i vijimësisë, deklaratat me shkrim të drejtimit, konfirmimet nga të tretët dhe dokumentimi i kushteve të angazhimit), si dhe dobësi në lidhjen ndërmjet procedurave të kryera dhe konkluzioneve të arritura. Po ashtu, u evidentuan raste të mos përditësimit të metodologjive të auditimit dhe të fletëve të punës në përputhje me zhvillimet më të fundit në standardet profesionale dhe Kodin e Etikës .

Megjithatë, një element pozitiv i procesit ishte niveli i përgjithshëm i bashkëpunimit nga subjektet e kontrolluara dhe pranimi i rekomandimeve të dhëna nga inspektorët. Në shumicën e rasteve, subjektet kanë paraqitur plane konkrete veprimi për adresimin e mangësive, me afate të përcaktuara, zakonisht brenda një periudhe 12-mujore, duke reflektuar një angazhim për përmirësimin e praktikave të tyre profesionale. Në tërësi, zbatimi i këtij modeli delegimi përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit të mbikëqyrjes dhe forcimit të cilësisë së auditimit në segmentin e njërive jo me interes publik. Procesi ka kontribuar në identifikimin e fushave për përmirësim në profesion, në rritjen e ndërgjegjësimit për kërkesat e standardeve ndërkombëtare dhe në nxitjen e një kulture më të fortë të cilësisë dhe llogaridhënies në auditim. Ai gjithashtu krijon një bazë të rëndësishme për ndërhyrje të mëtejshme rregullatore dhe përmirësime të vazhdueshme, në përputhje me objektivin strategjik të përafrimit me acqui të Bashkimit Evropian dhe forcimit të besimit publik në profesionin e auditimit.


4.5. Rezultatet e arritura - Treguesit e cilësisë së auditimit

Përgjatë këtyre viteve, bazuar në kontrollin e sigurimit të cilësisë së auditimit dhe vlerësimet përkatëse, në kuadër të aktivitetit mbikëqyrës që realizon Bordi i Mbikëqyrjes Publike, sigurimi i cilësisë në mbikëqyrjen e auditimit është një komponenti kryesor për të siguruar që procesi i auditimit t'i përmbahet standardeve të larta profesionale, me qëllim mbrojtjen e interesit të publikut dhe rritjen e besimit në raportimin financiar. Gjatë mbikëqyrjes së ushtruar për periudhën 2018 – 2025 janë kryer 129 kontrole të sigurimit të cilësisë, ku janë kontrolluar 155 angazhime auditimi, si edhe 45 kontrole të sigurimit në auditues ligjorë të angazhuar në njësi ekonomike jo me interes publik që janë deleguar për herë të parë organizatës profesionale të audituesve ligjorë, duke shënuar në total 174 kontrole të realizuara. Rezultatet e këtyre ndryshimeve thelbësore si edhe efektiviteti i mbikëqyrjes, kanë sjellë zhvillime të rëndësishme në tregun e auditimit dhe raportimit financiar. Qëllimi i kontroleve më bazë risku është identifikimi i çështjeve që mund të çojnë në dhënien e një opinionit jo të duhur të auditimit, nëpërmjet vlerësimit të sistemit të brendshëm të cilësisë dhe dosjes së angazhimit të auditimit.

Një indikator i rëndësishëm i përmirësimit të punës së audituesve, në mënyrën e organizimit të punës dhe kohës së angazhimit të tyre në misionet e auditimit, reflektohet jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar të njësisve ekonomike, por edhe në rritjen e konsiderueshme të totalit të vlerës së tregut, si një nga treguesit e rëndësishëm lidhur me vlerësimin e punës së audituesve rrjedhë e mbikëqyrjes për sigurimin e cilësisë. Ecuria e tregut të auditimit reflektohet në rritjen e qëndrueshme mesatare prej 14,38 përqind e të ardhurave vjetore të gjeneruara nga shërbimet e auditimit ligjor krahasuar me një rritje mesatare prej 5,9 përqind të njësisve ekonomike të audituara. Në mënyrë grafike ecuria e tregut të auditimit është paraqitur në vijim:




Në grafikun e mëposhtëm është ilustruar në mënyrë të përmblodhur veprimtaria mbikëqyrëse lidhur me kontrollin e sigurimit të cilësisë me bazë risku për vitet 2018-2025.



Nëse i referohemi objektivave për reduktimin e gjetjeve dhe sondazheve të realizuara ndër 56 rregullatorë në nivel ndërkombëtar nga kontrolli i angazhimeve të auditimit është e rëndësishme të evidentojmë se, sikurse natyra e gjetjeve është e njëjtë, po e njëjtë është edhe

ecuria e rënies së gjetjeve mesatare e kontrolleve të sigurimit të cilësisë, si në vendin tonë ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, si një indikator i objektivitetit që i bashkon mbikëqyrësit e auditimit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e gjetjeve mesatare të identifikuara përkundrejt angazhimeve të auditimit të nivel angazhimi gjatë periudhës 2018–2025:



Në vitet 2018–2021, pavarësisht numrit të angazhimeve të auditimit të kontrolluara, numri mesatar i gjetjeve për angazhim ka qenë në rritje duke shënuar deri në 25 gjetje mesatarisht për angazhim të kontrolluar. Në vijim, vërehet një ndryshim pozitiv, ku nga viti 2022 numri mesatar i gjetjeve për angazhim ka ndjekur një trajektore rënëse, duke reflektuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së auditimeve dhe efektivitetin e masave të ndërmarra për forcimin e kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e standardeve profesionale.

Kjo tregon se cilësia e auditimeve është përmirësuar dhe se proceset e kontrollit dhe mbikëqyrjes po japin rezultate konkrete kryesisht në reduktimin e numrit të gjetjeve sistemike si në nivel sistemi ashtu edhe në nivel angazhimi lidhur me:

- Mungesën e programeve të automatizuara
- Mos pajtueshmëritë me kërkesat përkatëse të etikës
- Mos pajtueshmëritë me kuadrin ligjor dhe rregullator
- Kryerjen e rishikimit të kontrollit të cilësisë për angazhimet e auditimit të NJEIP;
- Hartimin dhe publikimin e raportit të transparencës;
- Dhënien e informacionit për realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë;
- Dokumentimin e procedurave të punës dhe fletëve të punës të auditimit

5. Mbikëqyrja e organizatave profesionale

5.1. Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Audituesve Ligjorë

Në mbështetje të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë (IEKA) është subjekt i mbikëqyrjes prej Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Ligji i auditimit parashikon që disa nga veprimtaritë lidhur me profesionin që kryhen nga organizata profesionale e audituesve ligjorë nën mbikëqyrjen dhe rregullimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Gjatë vitit 2025, BMP është angazhuar në mbikëqyrjen e veprimtarisë së IEKA, lidhur me aktivitetet si në vijim:

- Hartimin e programit dhe përshtatshmëria e organizimit të Kualifikimit të Vijuëshëm Profesional;
- Regjistrimin dhe përditësimin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit nga Komiteti i Regjistrimit;
- Organizimin dhe zhvillimin e Asamblesë së Përgjithshme të anëtarëve të IEKA, zgjedhja e Këshillit Drejtues dhe organeve të tjera drejtuese, si edhe funksionimin e proceseve të brendshme për funksionimin e organizatës;
- Ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve për delegimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë për angazhimet e auditimit të njëjësive ekonomike jo me interes publik;
- Zbatimin e kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës nga anëtarësia.

Në këtë kontekst, midis BMP dhe IEKA ka pasur një ndërveprim të shtuar nëpërmjet takimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme përgjatë gjithë periudhës raportuese. Në fund të vitit 2025, anëtarët e BMP organizuan një takim me Këshillin e ri të Drejtimit të IEKA, lidhur me problematikat e identifikuara gjatë mbikëqyrjes, si edhe ndarjen e shqetësimeve lidhur me mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe përmirësimin dhe forcimin e mbikëqyrjes publike të profesionit të audituesit ligjor. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional, Këshilli i Drejtimit të IEKA u angazhua të ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e veprimtarisë dhe ushtrimin të funksioneve lidhur me çështjet si në vijim:

- **Përditësimin e Rregullores së Edukimit dhe Kualifikimit Profesional** nëpërmjet hartimit të një plani të detajuar veprimi për përditësimin e saj, si dhe të rregullores për realizimin e moduleve profesionale, në kuadër të edukimit të kandidatëve për auditues ligjorë.
- **Hartimi i planit vjetor për Kualifikimin e Vijuëshëm Profesional (KVP) për vitin 2026.**
- **Përmirësimi i proceseve të brendshme dhe forcimit të strukturës organizative** Organizatës i është kërkuar të hartojë një strategji dhe plan veprimi për forcimin e organizimit të brendshëm dhe rritjen e efikasitetit të funksionimit të saj.

- **Zbatimi dhe monitorimi i Kodit të Etikës** nëpërmjet një plani konkret për monitorimin e respektimit të Kodit të Etikës nga anëtarët, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit dhe ndjekjes së shkeljeve të mundshme.
- **Regjistrimi i përvitshëm dhe përditësimi në regjistrin publik të dhënave të publikueshme të audituesve dhe shoqërive të auditimit**, si një nga elementët thelbësorë të transparencës dhe kontrollit mbi profesionin.

Lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit në zbatim të rregullores nr. 10, datë 11.06.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e komitetit të regjistrimit dhe përditësimin e regjistrit publik”, e ndryshuar.

Gjatë vitit 2025 është realizuar mbikëqyrja e 6 (gjashtë) mbledhjeve të Komitetit të Regjistrimit, në të cilat janë marrë në total 36 (tridhjetegjashtë) vendime. Në kuadër të mbikëqyrjes të veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit nuk janë identifikuar çështje apo parregullsi që mund të përbëjnë mos pajtueshmëri me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator relevant për çështjet e regjistrimit/çregjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë.

Në vijim paraqitet një përmbledhje në formë tabelare e veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit gjatë vitit 2025:

Ndryshimet në regjistrin publik të audituesve ligjorë	Auditues ligjor (Person Fizik)	Shoqëri Auditimi	Auditues ligjorë që nuk e ushtrojnë profesionin*	Auditues ligjorë të dalë në pension
Regjistrimet për herë të parë	3	2	5	
Ri - Regjistrime	14	3		
Pezullime të përkohshme të ushtrimit të profesionit	4	4		
Çregjistrime	1			

*Shënim: Të cilët pajisen me numrin individual unik

5.2. Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar

Bazuar në rregulloren nr. 9, datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të kontabilistit të miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka vijuar mbikëqyrjen pranë OP të Kontabilistëve të Miratuar.

BMP ka vijuar me procedurat mbikëqyrëse të veprimtarisë së këtyre dy organizatave IKM dhe SHKFSH, me qëllim përmirësimin e funksionimit të tyre.

Struktura Mbështetëse e BMP është angazhuar në mbikëqyrjen e trajnimeve të zhvilluara për anëtarësinë në kuadër të edukimit të vijueshëm profesional për vitin 2025, si dhe mbledhjes së Asamblesë së zhvilluar nga IKM, ku është kryer monitorimi i zhvillimit të mbledhjes, përfshirë procedurat, respektimi i Statutit të organizatës, diskutimet e zhvilluara dhe procesi i votimit sipas pikave të rendit të ditës.

Në vijim të përmbushjes së procesit të verifikimit të përputhshmërisë së kontabilistëve të miratuar (KM), të zhvilluar nga organizatat profesionale, deri më tani numri i kontabilistëve të miratuar të regjistruar në regjistrin publik pranë të dy shoqatave profesionale të kontabilistëve të miratuar në total është 492 KM nga të cilët 407 e ushtrojnë aktivitetin si person fizik dhe 85 në shoqëri kontabiliteti.

Qëllimi i procesit të verifikimit të kontabilistëve të miratuar është formalizimi i ushtrimit të veprimtarisë të gjithë zotëruesve të titullit, duke garantuar zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me detyrimet që përfshijnë zbatimin e standardeve etike dhe kërkesave të tjera në zbatim të akteve ligjore, duke garantuar ndër të tjera që shërbimi i kontabilistëve të miratuar të mos ofrohet nga individë apo subjekte të tjerë të pa licencuar, apo që konkurrojnë në mënyrë të padrejtë me ushtruesit e rregullt të profesionit. Finalizimi i këtij procesi është përfshirja e KM-ve të cilët përmbushin kriteret ligjore të parashikuara, në regjistrin e konsoliduar publik të kontabilistëve të miratuar, i cili është i aksesueshëm nga të gjitha palët e interesuara.

6. Bashkëpunime ndërinstitucionale dhe institucionet homologe ndërkombëtare

Bashkëpunimi me Agjencinë e Inteligjencës Financiare dhe Moneyval

Bordi i Mbikëqyrjes Publike në mënyrë të vazhdueshme ka vijuar bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve raportuese me Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF) për të vënë në zbatim të gjitha kërkesat që vijnë nga rekomandimet e Komitetit Moneyval dhe nga FATF për matjen e efektivitetit të zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe ka realizuar një sërë takimesh si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e këtyre rekomandimeve. Gjatë vitit 2025, në vijim të vendimit të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) për ngritjen e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës (GTNP) me qëllim koordinimin e punës ndërinstitucionale në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, BMP ka luajtur një rol aktiv në takimet periodike të realizuara duke kontribuar në hartimin dhe zbatimin e planit veprimi, në proceset ndërkombëtare të vlerësimit dhe monitorimit, në hartimin e strategjisë dhe Vlerësimit Kombëtar të Riskut bashkë me planin përkatës të zbatimit.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe janë fokusuar në rritjen e efektivitetit institucional, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe avancimin e përgatitjeve në kuadër të procesit të vlerësimit nga Moneyval.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, diskutimet u përqendruan në qartësimin e roleve dhe përgjegjësi të institucioneve për zbatimin e planeve të veprimi që lidhen me rezultatet imediate kyçe, duke përfshirë forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, përmirësimin e

mbikëqyrjes së sektorit financiar dhe VASP-ve, si dhe rritjen e efektivitetit në hetimin dhe ndëshkimin e pastrimit të parave. Një rëndësi e veçantë iu kushtua gjithashtu masave për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve, si dhe parandalimit të financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Në këtë kuadër, theksi u vendos mbi koordinimin institucional dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rritjen e efektivitetit të sistemit.

Vlerësimi i progresit institucional dhe adresimit të mangësive të identifikuar gjatë ushtrimeve simuluese për rezultatet imediate, mori një rëndësi të veçantë, së bashku me rritjen e ndërgjegjësimit përmes trajnimeve dhe edukimit publik mbi rreziqet që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Në këtë kuadër, Bordi raportoi mbi zbatimin e planit individual të veprimit dhe kontributin e tij në Planin e Integruar të Trajnimeve, si pjesë e përpjekjeve për forcimin e kapaciteteve institucionale.

Në vijim, mbledhjet periodike u fokusuan në monitorimin e zbatimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut (NRA) dhe në nevojën për përditësimin e masave në përputhje me rreziqet aktuale. Një komponent i rëndësishëm i diskutimeve ishte progresi në plotësimin e Pyetësorit të Teknikalitetit për Raundin e 6-të të Moneyval, ku u evidentuan sfidat e hasura dhe u theksua nevoja për përmirësimin e cilësisë së raportimit dhe koordinimit ndër-institucional.

Në fund të vitit, aktivitetet u përqendruan në monitorimin e zbatimit të dokumenteve strategjike kryesore, përfshirë Strategjinë Kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024–2027 dhe Vlerësimin Kombëtar të Riskut. Gjithashtu, u trajtua progresi në zbatimin e strategjisë për edukimin e publikut dhe i Planit të Integruar të Trajnimeve, me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve pjesëmarrëse.

Gjatë periudhës raportuese, BMP ka raportuar mbi ecurinë e plotësimin të Pyetësorit të Efektivitetit, duke identifikuar njëkohësisht nevojën për përmirësimin e proceseve të monitorimit dhe raportimit. Në këtë kontekst, u miratua edhe Plani i Integruar i Trajnimeve për vitin 2026, duke reflektuar prioritetet e identifikuar dhe duke synuar forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale.

Në tërësi, aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2025 dëshmojnë për një angazhim të qëndrueshëm të Bordit dhe institucioneve partnere në përmirësimin e efektivitetit të sistemit kombëtar kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional, rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të vazhdueshëm të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit.

6.1. Anëtarësimi i BMP në IFIAR – Angazhim për Cilësi dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Që prej vitit 2011, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) është anëtar me të drejta të plota në Forumin Ndërkombëtar të Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit (IFIAR), një rrjet prej 56 juridiksionesh që synon përmirësimin global të cilësisë së auditimit dhe mbrojtjen e interesit publik përmes bashkëpunimit rregullator.

Anëtarësimi në IFIAR i mundëson BMP-së:

- Të jetë pjesë e një platforme ndërkombëtare për shkëmbimin e eksperiencës në mbikëqyrjen e auditimit;
- Të përafrojnë praktikat kombëtare me standardet ndërkombëtare, veçanërisht në fushat e kontrollit të cilësisë, etikës profesionale dhe masave disiplinore;
- Të kontribuojë në zhvillimin e politikave globale që ndikojnë cilësinë e raportimit financiar dhe besimin e investitorëve.

Gjatë vitit 2025, BMP ka vijuar të jetë pjesë aktive në aktivitetet e IFIAR përmes raportimeve statistikore, shkëmbimeve të njohurive dhe angazhimit në diskutimet mbi rreziqet e reja në tregun e auditimit. Pjesëmarrja në mbledhjet vjetore dhe votimi për çështje strategjike të anëtarësisë janë një tjetër shenjë e angazhimit aktiv të BMP-së në rrjetin ndërkombëtar të mbikëqyrësve të auditimit.

6.2. Roli i BMP në Grupin e Punës për Zbatimin e Masave Disiplinore – IFIAR Enforcement Working Group

Gjatë vitit 2025, Bordi i Mbikëqyrjes Publike si **anëtar i Grupit të Punës për Masat Shtrënguese (Enforcement Working Group)** të IFIAR, u përfaqësua në dy panele prezantimi lidhur me çështjet e masave shtrënguese dhe investigimit gjatë Seminarit mbi Zbatimin e Masave Disiplinore (Enforcement Workshop), një forum i rëndësishëm global që synon forcimin e koordinimit ndërkombëtar për investigimin dhe masat disiplinore, me qëllim rritjen e cilësisë së auditimit dhe mbrojtjen e interesit të publikut.

Ky event mbledhi së bashku profesionistë të masave shtrënguese të autoriteteve rregullatore të auditimit nga e gjithë bota, për të ndarë përvojat praktike, në funksion të zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe rritjen e efektivitetit të masave shtrënguese.

Përfaqësimi i BMP reflekton angazhimin e vazhdueshëm të BMP për forcimin e sistemit të mbikëqyrjes.

BMP ka kontribuar aktivisht gjatë vitit në takimet online dhe me prani fizike të grupit, si dhe në prezantime të përbashkëta që analizojnë efektivitetin e masave shtrënguese si element kyç në garantimin e cilësisë së auditimit. Përfshirja në këtë grup përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së kapaciteteve institucionale të BMP dhe promovon imazhin e mbikëqyrjes të profesionit të auditimit në nivel ndërkombëtar.

Përfshirja aktive e Bordit të Mbikëqyrjes Publike në IFIAR dhe veçanërisht në Grupin e Punës për Masat Shtrënguese përfaqëson një element të rëndësishëm të strategjisë institucionale për forcimin e rolit rregullator, rritjen e kapaciteteve dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare. Këto angazhime synojnë jo vetëm përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe mbikëqyrjes, por gjithashtu rrisin besimin e publikut dhe investitorëve në integritetin e sistemit të raportimit financiar në Shqipëri. Në përputhje me objektivat e përcaktuara në kuadër të reformës së mbikëqyrjes dhe përmbushjes së detyrimeve të procesit të integritetit evropian, BMP do të vijojë të forcojë përfshirjen ndërkombëtare dhe të adoptojë praktikat më të mira të rregullimit global në mbrojtje të interesit publik.

6.3. Roli i BMP si anëtar vëzhgues në Komitetin e Autoriteteve Evropiane të Mbikëqyrjes së Auditimit (CEAOB)

Komiteti i Autoriteteve Evropiane të Mbikëqyrjes së Auditimit (CEAOB), në mbledhjen e tij të 29-të Plenare të zhvilluar në Bruksel më 18–19 Nëntor 2025, ka miratuar Bordin e Mbikëqyrjes Publike (BMP) me statusin e anëtarit vëzhgues në nivel Plenar.

CEAOB është krijuar në kuadër të bashkëpunimit midis shteteve anëtare të BE për mbikëqyrjen e auditimit në zbatim të dispozitave të rregullores 537/2014. Roli i tij është të forcojë mbikëqyrjen e auditimit në të gjithë BE, duke lehtësuar konvergjencën mbikëqyrëse dhe me qëllim zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të legjislacionit të auditimit në të gjithë BE.

CEAOB përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve të mbikëqyrjes së auditimit të shteteve anëtare të BE dhe Autoritetit Evropian të Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (ESMA). Gjithashtu, Komisioni Evropian emëron si Zëvendëskryetar të CEOB, personin që mban pozicionin dhe ushtron funksionin e Drejtorit nga Drejtoria e Përgjithshme për Stabilitetin Financiar, Shërbimet Financiare dhe Unionin e Tregjeve të Kapitalit (DG FISMA) përgjegjës për politikën që lidhen me auditimin ligjor.

Ky status e vendos BMP krahas autoriteteve homologe të BE dhe konfirmon se Shqipëria ka përparuar në harmonizimin e legjislacionit të auditimit me Acqui. Përfaqësimi zyrtar në strukturat e Komiteteve të ngritura nga Këshilli i Evropës për mbikëqyrjen e auditimit, do të jetë një shtyllë e rëndësishme për adresimin e rekomandimeve në Progres Raportin në kuadër të Kapitullit 6.

Ky zhvillim shërben si një tregues i rëndësishëm për suksesin e reformave të implementuara nga Ministria e Financave (MF), në kuadër të programeve të financuar nga SECO dhe BE të zbatuara me drejtimin dhe mbështetjen strategjike të Bankës Botërore në fushën e auditimit dhe raportimit financiar, si shprehje e angazhimit të Qeverisë në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

Ky status është një arritje e rëndësishme institucionale për BMP, pasi mundëson:

- Përfaqësim në mbledhjet plenare të CEOB – forumin më të rëndësishëm të autoriteteve mbikëqyrëse të auditimit në BE;
- Qasje të drejtpërdrejtë në diskutime teknike dhe shkëmbim përvojash mbi mbikëqyrjen, kontrollin e sigurimit të cilësisë së auditimit, masat shtrënguese për zbatimin e kadrës ligjor dhe rregullator;
- Forcim të bashkëpunimit institucional dhe harmonizimit me praktikën më të mira dhe standardet e BE, në funksion të rritjes së cilësisë së auditimit dhe besimit publik në raportimin financiar në Shqipëri.

Statusi i anëtarit vëzhgues, në strukturën më të lartë profesionale dhe rregullatore për auditimin brenda BE, shënon një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së objektivit strategjik kryesor të

vendit tonë të integritit dhe me anëtarësimin e Shqipërisë në BE, BMP do të jetë anëtar me të drejta të plota i CEAOB.

6.4. Bashkëpunimi me Bankën Botërore për Forcimin e Kapaciteteve dhe Cilësisë së Auditimit

Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR), me seli në Vjenë, Austri, është përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të Bankës Botërore në fushën e raportimit financiar në Evropë dhe Azinë Qendrore. Qendra ofron asistencë teknike dhe ndihmë për zhvillimin e kapaciteteve institucionale në vendet përfituese, duke promovuar përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar dhe auditimit.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), përmes projekteve të Bankës Botërore për forcimin e kapaciteteve të institucioneve rregullatorë dhe organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, ka bashkëpunuar ngushtësisht me CFRR gjatë vitit 2025 me synimin për të konsoliduar më tej rolin mbikëqyrës dhe për të rritur cilësinë e auditimit ligjor dhe raportimit financiar. Gjatë vitit 2025, BMP ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve të organizuara në kuadër të iniciativave rajonale dhe kombëtare si:

- Konferencën Ministrore mbi reformat për raportimin financiar dhe raportimin e qëndrueshmërisë: Orientimi mes agjendës së gjelbër dhe digjitale;
- Progresi i Reformave të Mbikëqyrjes së Auditimit.

Aktivitetet për vitin 2025 përfshijnë:

- **18 Mars 2025 – Vjenë, Austri**

Konferenca Ministrore

BMP ka marrë pjesë në Konferencën Ministrore në Vjenë me temë “Reformat për raportimin financiar dhe raportimin e qëndrueshmërisë: Orientimi mes agjendës së gjelbër dhe digjitale”. Kjo konferencë e organizuar nga Qendra e Bankës Botërore (BB) për Reformën e Raportimit Financiar dhe Qëndrueshmërisë (CFRR), kishte si objektiv kryesor mobilizimin e mbështetjes politike për reformat në fushën e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Z. Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në fjalën e tij theksoj punën e ngushtë me Bankën Botërore për hartimin e një Plani Kombëtar Veprimi për Raportimin e Qëndrueshmërisë, i cili do të adresojë aspekte rregullatorë, edukimin dhe trajnimin e biznesit, monitorimin dhe zbatimin e këtyre rregullave, si dhe bashkëpunimin me organizatat e industrisë për të zhvilluar e promovuar raportimin e qëndrueshmërisë”.

Gjithashtu, në sektorin publik, Shqipëria po integron raportimin e qëndrueshmërisë në strategjitë kombëtare dhe financave publike, në përputhje me objektivat ndërkombëtare, duke marrë shembull nga praktikat më të mira evropiane. Në të njëjtën kohë, po reformohet dhe kuadri i raportimit financiar dhe jo financiar në sektorin publik, duke synuar zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

- **09 - 10 Dhjetor 2025**

Forumit rajonal për “Mbikëqyrjen e Auditimit”, vlerësohet roli i BMP për reformat dhe integrimin në BE

Për herë të parë në Tiranë u organizua Forumi IV rajonal për sigurimin e cilësisë së auditimit, duke patur në fokus Shqipërinë si rast suksesi, si dhe praktikatat e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Forumit me temë “Progresi i Reformave të Mbikëqyrjes së Auditimit”, organizuar nga Qendra Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar dhe të Qëndrueshmërisë (CFRR), ka si qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë së auditimit në vendet e Ballkanit Perëndimor nëpërmjet të mësuarit, shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunimit rajonal.

Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në fjalën e tij, theksoi se kuadri rregullator i Shqipërisë është rishikuar dhe zhvilluar plotësisht në përputhje me kuadrin evropian të auditimit dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

“Reforma e BMP krijoi qëndrueshmëri afatgjatë në kryerjen e kontrolleve të sigurimit të cilësisë të bazuar në risk, nga ku sot numërohen më shumë se 150 kontrolle të kryera bazuar në këtë qasje. Udhëtimi i BMP është i shkurtër deri më tani tregon një të vërtetë të thjeshtë: mbikëqyrja e fortë nuk është ndëshkuese, por është transformuese. Në Shqipëri, profesioni ka pranuar që cilësia nuk është opsionale, por është thelbësore”.

6.5. Bashkimi Evropian – Progres Raporti

Komisioni Evropian mbajti takimin e nën komitetit për vitin 2025, gjatë të cilit Bordi i Mbikëqyrjes Publike raportoi lidhur me ndryshimet ligjore të ndërmarra në fushën e auditimit ligjor, me qëllim përafrimin me kuadrin e BE, përkatësisht me Direktivën 2006/43/EC dhe Rregulloren 537/2014. Gjithashtu, u raportua mbi miratimin e akteve nënligjore përkatëse, duke synuar siguruar e harmonizimit të plotë me këto akte. Gjithashtu, BMP prezantoi përfshirjen e tij në strukturat e Komitetit të Autoriteteve Evropiane të Mbikëqyrjes së Auditimit (CEAOB), që ka në përbërje rregullatorët nga shtetet anëtare të BE për mbikëqyrjen e auditimit në zbatim të dispozitave të rregullores BE 537/2014.

Në fund të vitit 2025, BMP përcolli pranë Komisionit Evropian paketën e plotë lidhur me përmbushjen e planit të punës për piketat përmbyllëse për kapitullin 6 “Legjislacioni për shoqëritë tregtare”, duke përfshirë:

1. Ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar;
2. Tabelën e Përputhshmërisë;
3. Rregulloren “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”, miratuar me Vendimin nr. 43 datë 30.09.2025 të BMP, dhe e publikuar në fletoren zyrtare Nr.183 datë 09.10.2025;

4. Rregulloren “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit”, miratuar me Vendimin nr. 44 datë 30.09.2025 të BMP, dhe e publikuar në fletoren zyrtare Nr.183 datë 09.10.2025;
5. Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Regjistrimit dhe përditësimin e regjistrimit publik”, miratuar me Vendimin nr. 53 datë 26.11.2025 të BMP, dhe e publikuar në fletoren zyrtare nr. 230 datë 11.12.2025;
6. Rregulloren “Për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit” miratuar me Vendimin nr. 55 datë 26.11.2025 të BMP, dhe e publikuar në fletoren zyrtare nr. 230 datë 11.12.2025;
7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.01.2019 “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”, e ndryshuar;
8. Analiza e sistemit të mbikëqyrjes së auditimit në Shqipëri.

Hapja e negociatave në Tetor 2024, për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian shënon një moment kyç për përshpejtimin e reformave në fushën e qeverisjes ekonomike dhe financiare. Brenda kuadrit të Kapitullit 6 – “Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare”, nën-kapitulli “Auditimi dhe kontabiliteti” kërkohet përafrimi i plotë i legjislacionit dhe praktikave mbikëqyrëse me *acqui communautaire*. Në këtë kontekst, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) luan një rol qendror si autoriteti i pavarur rregullator përgjegjës për mbikëqyrjen e auditimit ligjor dhe për garantimin e integritetit dhe cilësisë së raportimit financiar. BMP është i angazhuar në raportimin periodik të progresit përmes kapitullit përkatës të negociatave, duke evidentuar zbatimin e kërkesave të BE-së, si dhe duke kontribuar në forcimin e besueshmërisë dhe transparencës së sistemit të auditimit dhe kontabilitetit në vend. Ky rol mbështet drejtpërdrejt procesin e integritetit evropian dhe avancimin e shtetit të së drejtës në fushën ekonomike.

Progres Raporti, përkatësisht në kapitullin nr. 6 të tij, ka vlerësuar punën e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, duke vënë theksin tek roli i Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës, si dhe adresimi ligjor përfshirë marrjen e masave disiplinore për audituesit ligjorë që shkelin ligjin dhe standardet profesionale, në funksion të mbrojtjes së interesit publik. Duke nënvizuar rëndësinë e fuqizimit të kapaciteteve dhe rolit të BMP-së për të mundësuar përafrimin me rregullat e auditimit ligjor të BE-së.

6.6. Bashkëpunimi me rregullatorë të tjerë në rajon dhe organizata të tjera rajonale

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, në kryerjen e aktiviteteve të veta, në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunon me institucionet homologe të rajonit, veçanërisht për çështje të shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave të lidhura me kontrollin e cilësisë. Ky bashkëpunim konsiderohet i rëndësishëm për konsolidimin e marrëdhënieve ndërmjet rregullatorëve të rajonit dhe në vijim pritet që ky bashkëpunim të konsolidohet edhe më tej në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave apo rritjen e kapaciteteve të stafit të strukturës mbështetëse.

7. Prioritetet dhe objektivat për vitin 2026

7.1. Mbiqëqyrja dhe sigurimi i cilësisë të auditimit ligjor

Aktiviteti kryesor i BMP mbetet sigurimi i cilësisë së auditimit ligjor dhe raportimit financiar nëpërmjet kryerjes së procesit të kontrollit të cilësisë. Për vitin 2026, është planifikuar kryerja e 30 kontrolleve të sigurimit të cilësisë, duke i dhënë prioritet zbatimit të kërkesave ligjore që lidhen me përmbushjen e ciklit të realizimit të kontrollit dhe analizës së riskut të angazhimeve të auditimit.

Në të njëjtën kohë, këto kontrolle synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së praktikës së auditimit, veçanërisht tek praktikuesit e vegjël dhe të mesëm, përmes identifikimit të mangësive dhe ofrimit të rekomandimeve konkrete për përmirësim. Një fokus i veçantë i kushtohet rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve ligjorë praktikues të vetëm, si dhe të personelit mbështetës të përfshirë në realizimin e angazhimeve të ofrimit të sigurisë (auditimit dhe shërbimeve të tjera të sigurisë), duke nxitur forcimin e sistemeve të kontrollit të cilësisë dhe përmirësimin e dokumentimit dhe zbatimit të procedurave të auditimit.

Gjithashtu, procesi i inspektimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë do të vijojë të shërbejë si një mekanizëm i rëndësishëm për transferimin e njohurive dhe përvojës së ekipit të BMP tek shoqëritë e auditimit dhe audituesit ligjorë. Ky ndërveprim gjatë inspektimeve kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit profesional dhe zbatimin e praktikave më të mira, duke u përkthyer në një proces zhvillues dhe përmirësues në aspektin e cilësisë së punës për të gjitha palët e përfshira.

Fokusi kryesor i inspektimit është vlerësimi i cilësisë së dokumentacionit të angazhimit të auditimit dhe të nivelit të përputhshmërisë me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator, kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës dhe standardet ndërkombëtare të auditimit dhe dhënies së sigurisë.

7.2. Mbiqëqyrja e hyrjes në profesion dhe procesit të provimit të aftësive profesionale

Gjatë vitit 2026, BMP do të forcojë më tej bashkëpunimin me organizatat profesionale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së formimit dhe rritjen e kapaciteteve të kandidatëve që hyjnë në profesionin e auditimit. Ky bashkëpunim do të fokusohet në përditësimin e kurrikulave në përputhje me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare, duke përfshirë në mënyrë të veçantë raportimin e qëndrueshmërisë dhe dhënien e sigurisë mbi raportimin e qëndrueshëm, në linjë me kërkesat dhe standardet evropiane. Njëkohësisht, do të ndërmerren masa konkrete për përmirësimin e procesit të testimit në kuadër të provimit të aftësive profesionale, duke siguruar rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së vlerësimit të kandidatëve. Në këtë kontekst, BMP do të garantojë vijimësinë dhe zhvillimin e këtij procesi gjatë vitit 2026, duke adresuar shtyrjen e tij

nga viti 2025 dhe duke siguruar një organizim më të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Filozofia e BMP ndaj KPAP do të jetë ta orientojë këtë strukturë nga një proces kryesisht administrativ drejt një mekanizmi thelbësor për garantimin e cilësisë së hyrjes në profesion, forcimin e besueshmërisë së certifikimit dhe përmbushjen e pritshmërive në rritje të kandidatëve dhe publikut. Në këtë drejtim, BMP synon të vendosë një qasje më proaktive, të bazuar në standarde të qarta, transparencë dhe llogaridhënie, duke e konsideruar procesin e provimeve si një hallkë kritike në zinxhirin e cilësisë së profesionit. Një qasje parandaluese dhe e strukturuar, e mbështetur në planifikim të qëndrueshëm, përmirësim të vazhdueshëm të procedurave dhe forcim të kapaciteteve, do të garantojë vijimësinë e procesit dhe stabilitetin organizativ, për rikthimin dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e provimeve.

7.3. Kontributi i BMP në forcimin e kuadrit AML/CFT dhe procesin e integritetit evropian

Gjatë vitit 2026, BMP synon të luajë një rol aktiv dhe të strukturuar në procesin e raportimit dhe vlerësimit në kuadër të raundit të 6 të Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës, duke kontribuar në demonstrimin e efektivitetit të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Në këtë kuadër, BMP do të forcojë rolin e saj si autoritet mbikëqyrës për profesionet e lira të caktuara jo financiare (DNFBP), përmes raportimit të strukturuar të statistikave dhe rezultateve të mbikëqyrjes së profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar, duke u bazuar në qasjen e mbikëqyrjes së orientuar nga rreziku në fushën e PP/FT.

Njëkohësisht, BMP do të vijojë kontributin e saj në kuadër të Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 222, datë 26.11.2025, për harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me acqui të Bashkimit Evropian në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të Kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”, seksioni 4.3. Në vijim të punës së këtij grupi dhe hartimit të projektligjit përkatës, i cili transponon Direktivën (BE) 2024/1640 (Direktiva e 6-të AML) dhe harmonizohet me Rregulloren (BE) 2024/1624, BMP do të angazhohet në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të kërkesave të reja ligjore.

Objektivi kryesor në këtë drejtim mbetet sigurimi i një mbikëqyrjeje efektive dhe të bazuar në rrezik ndaj profesionit, si dhe forcimi i mekanizmave për identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

7.4. Roli dhe kontributi i BMP në përmbushjen e Kapitullit 6 të acquis të BE-së ("Legjislacioni për shoqëritë tregtare")

BMP do të vijojë angazhimin nëpërmjet kontributit në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e piketave përmbyllëse të Kapitullit 6 "Legjislacioni për shoqëritë tregtare", përmes forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse dhe zbatimit efektiv të kuadrit të ri ligjor dhe nënligjor të miratuar në fushën e auditimit ligjor dhe mbikëqyrjes publike. Në këtë kuadër, fokusi kryesor do të jetë implementimi i planit të punës që lidhet me demonstrimin e funksionimit praktik dhe efektiv të sistemit të mbikëqyrjes, në përputhje me kërkesat e acqui të Bashkimit Evropian.

Në funksion të këtij objekti, BMP do të vijojë të mbështesë procesin e integritimit evropian përmes dokumentimit dhe raportimit të progresit të arritur, duke reflektuar zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të përafuar me Direktivën 2006/43/EC dhe Rregulloren (BE) 537/2014. Në këtë drejtim, tashmë është dërguar në Komisionin Evropian një paketë e plotë dokumentacioni që përfshin kuadrin ligjor dhe rregullator të përditësuar, tabelat e përputhshmërisë, si dhe aktet nënligjore të miratuara nga BMP, të cilat adresojnë fusha kyçe si sistemi i sigurimit të cilësisë, procedurat e hetimit dhe disiplinës, regjistri publik, si dhe bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2026, BMP do të fokusohet në vijimin e reformave në aktet nënligjore me qëllim forcimin e mëtejshëm institucional dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore për zbatimin efektiv të funksioneve mbikëqyrëse. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke garantuar një sistem mbikëqyrjeje të qëndrueshëm dhe në përputhje të plotë me standardet e Bashkimit Evropian. Ky angazhim synon të kontribuojë drejtpërdrejt në avancimin e procesit të negociatave dhe përmbushjen e kriterëve për mbylljen e Kapitullit 6.

Në të njëjtën kohë, duke u bazuar në statusin e fituar si anëtar vëzhgues në nivel plenar pranë Committee of European Auditing Oversight Bodies (CEAOB), BMP do të intensifikojë përpjekjet për thellimin e integritimit në strukturat evropiane të mbikëqyrjes së auditimit. Në këtë kuadër, një prioritet i rëndësishëm për vitin 2026 do të jetë angazhimi aktiv dhe përpjekjet për anëtarësim në grupin e punës për inspektimet pranë CEOB, me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përafrimin e mëtejshëm me metodologjitë e inspektimit të aplikuara në vendet e Bashkimit Evropian.

7.5. Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe zhvillimi profesional i stafit, dhe përmirësimi i efektivitetit institucional

BMP synon të forcojë kapacitetet e saj institucionale përmes investimit të qëndrueshëm në burimet njerëzore dhe përmirësimin e proceseve të brendshme, duke njohur se kapitali njerëzor përbën aset më të vlefshëm për realizimin efektiv të misionit të saj.

Në këtë kuadër, BMP do të fokusohet jo vetëm në shtimin e stafit, por edhe në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale të tij, duke rritur ekspertizën në zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, realizimin e kontroleve të sigurimit të cilësisë, si dhe në proceset e investigimit dhe marrjes së masave disiplinore. Përmes programeve të trajnimit dhe zhvillimit profesional, do të synohet forcimi i kompetencave teknike dhe rritja e performancës së përgjithshme institucionale.

Njëkohësisht, BMP do të ndërmarrë masa për të rritur angazhimin dhe mirëqenien e stafit, duke promovuar një kulturë pune gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese, si dhe duke krijuar kushte që favorizojnë fleksibilitetin, autonominë dhe ndërveprimin efektiv ndërmjet stafit. Këto masa synojnë jo vetëm ruajtjen e stafit ekzistues, por edhe tërheqjen e profesionistëve të rinj dhe të kualifikuar, në funksion të përmbushjes më efektive të mbikëqyrjes dhe rritjes së cilësisë së proceseve institucionale. Në këtë kuadër, do të propozohet edhe rishikimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, i ndryshuar, me fokus forcimin e mirëqenies dhe garantimin e mbarëvajtjes së qëndrueshme dhe të shëndetshme të një stafi cilësor, si dhe të funksionimit efektiv të komiteteve të ngritura pranë BMP, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe koherencës në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse.

Në drejtim të përmirësimit të proceseve të brendshme, BMP do të synojë rritjen e efikasitetit operacional përmes optimizimit të procedurave, eliminimit të barrierave organizative dhe përdorimit të mjeteve mbështetëse që lehtësojnë punën e ekipit. Gjithashtu, do të promovohet një qasje më fleksibile dhe e orientuar drejt rezultateve, duke përmirësuar koordinimin e brendshëm dhe proceset e vendimmarrjes.

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve, BMP synon të rrisë ndikimin e saj institucional dhe të përmbushë në mënyrë më efektive dhe të qëndrueshme objektivat strategjike dhe detyrimet që rrjedhin nga misioni i saj.

7.6. Mbikëqyrja e organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale

BMP do të vijojë me bashkëpunimin në kuadër të funksionit mbikëqyrës ndaj Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), me fokus në përmirësimin e funksionimit të proceseve kryesore që lidhen me zhvillimin profesional, regjistrimin dhe përkthimin e standardeve profesionale, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në këtë kuadër, BMP do të vijojë mbikëqyrjen e procesit të Edukimit të Vijueshëm Profesional, duke synuar rritjen e cilësisë dhe temave të programeve të trajnimit, si dhe përmirësimin e strukturimit të kurrikulave të programit të kualifikimit dhe stazhit profesional për kandidatët për auditues ligjor. Një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet bashkëpunimit dhe kontributit të

BMP në përmirësimin e rregulloreve përkatëse, për të siguruar zbatimin sa më efektiv të tyre dhe përmbajtje më të përshtatur me zhvillimet e profesionit.

BMP do të vijojë gjithashtu mbikëqyrjen e Komitetit të Regjistrimit (KR) dhe proceseve për përditësimin e regjistrimit publik, duke synuar monitorimin e vazhdueshëm të regjistrimit publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, si dhe rritjen e transparencës dhe saktësisë së të dhënave të publikuara. Gjithashtu, një vëmendje do të kushtohet rishikimit të rregullave të funksionimit të tij, me qëllim garantimin e transparencës dhe saktësisë së të dhënave. Paralelisht, do të monitorohet progresi në përkthimin dhe adoptimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe dhënies së sigurisë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm do të jetë edhe ndjekja e zbatimit të kërkesave ligjore lidhur me regjistrimin e përvitshëm dhe përditësimin e të dhënave në regjistrin publik të audituesve dhe shoqërive të auditimit, si element thelbësor i transparencës dhe mbikëqyrjes efektive

Në këtë kontekst, BMP do të inkurajojë dhe monitorojë hartimin dhe zbatimin e strategjisë dhe planeve të veprimit të IEKA për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e menaxhimit të proceseve të brendshme, si dhe do të mbikëqyrë zbatimin efektiv të Kodit të Etikës nga anëtarësia, duke kontribuar në rritjen e integritetit dhe profesionalizmit në ushtrimin e profesionit.

7.7. Mbikëqyrja e profesionit të kontabilistëve të miratuar

Në kuadër të rregullimit dhe mbikëqyrjes së profesionit të Kontabilistëve të Miratuar të parashikuar në rregulloren nr. 9/2019, proceset dhe aktivitetet e planifikuara do të jenë në nivel mbikëqyrje dhe koordinim të ushtrimit të profesionit të kontabilistit të miratuar, verifikimit të KM-ve dhe çështjeve të edukimit të vijueshëm profesional, nëpërmjet mbikëqyrjes të veprimtarisë dhe ndërveprimit me organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar të njohura nga BMP.

Ky bashkëpunim do të vijojë dhe do të forcohet më tej, duke synuar përmirësimin e komunikimit dhe koordinimit me organizatat profesionale, në funksion të një mbikëqyrjeje më efektive, transparente dhe të qëndrueshme të profesionit.

7.8. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në funksion të stabilitetit financiar dhe cilësisë së raportimit

Gjatë vitit 2026, BMP synon të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional me autoritetet kryesore rregullatore, në veçanti me Bankën e Shqipërisë, me qëllim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së auditimit ligjor dhe raportimit financiar, si komponentë thelbësorë për garantimin e transparencës, besueshmërisë dhe integritetit të informacionit financiar në vend.

Në këtë kuadër, BMP do të angazohet për formalizimin e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi, e cila do të mundësojë shkëmbimin e strukturuar të informacionit, koordinimin e mekanizmave mbikëqyrës dhe ndarjen e ekspertizës ndërmjet institucioneve. Ky bashkëpunim synon të kontribuojë në forcimin e kuadrit rregullator dhe të kontrollit, si dhe në një mbikëqyrje më të integruar dhe efektive të sektorit financiar, biznesit dhe profesionit të auditimit. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, BMP synon të mbështesë rritjen e besimit të publikut dhe investitorëve në tregjet financiare, si dhe të kontribuojë drejtpërdrejt në ruajtjen e stabilitetit dhe efikasitetit të sistemit financiar në Shqipëri, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat e integritetit evropian.

Me prioritet të rëndësishëm do të vijohet me thellimin e bashkëpunimeve ndërinstitucionale për rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes. BMP do të vijojë dhe do të forcojë më tej bashkëpunimin me institucione si AMF, DPT, QKB, KKK dhe institucione të tjera rregullatore, si edhe zgjerimin e bashkëpunimit me shoqatat e biznesit dhe institucionet e drejtësisë për promovimin e integritetit dhe transparencës institucionale.

Ky raport është përgatitur vetëm për informacion të përgjithshëm. BMP nuk pranon asnjë përgjegjësi ndaj ndonjë pale për humbje, dëmtime ose shpenzime, pavarësisht nëse janë në kontratë, kundërvajtje ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ndonjë veprim apo vendim i marrë (ose jo), si rezultat i ndonjë personi që mbështetet në këtë raport ose e përdor gjetje të pasqyruara në të.

8. *Aneks - Pasqyrat Financiare me Raportin e Audituesit të Pavarur më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025*

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Pasqyrat Financiare me Raportin e Audituesit të Pavarur

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur.....	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	1
Pasqyra e Aktiviteteve.....	2
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare	3
Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare.....	4
1 Informacion i Përgjithshëm	4
2 Baza e përgatitjes.....	4
3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël.....	5
4 Mjete Monetare dhe ekuivalentët e tyre	8
5 Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm	8
6 Shpenzime të parapaguara.....	8
7 Të ardhura të konstatuara	8
8 Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.....	9
9 Të pagueshme.....	10
10 Të ardhura të marra në avancë nga procesi i provimit përfundimtar të aftësive profesionale	10
11 Të ardhurat	10
12 Shpenzime për aktivitetet	11
13 Të ardhura/ shpenzime bankare/ kurs këmbimi.....	11
14 Informacione lidhur me procesin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale	12
15 Të ardhurat dhe shpenzimet për aktivitetet e BMP	12
16 Rritja/ Rënia në aktivet neto	13
17 Masa disiplinore dhe ceshtje gjyqësore.....	13
18 Ngjarjet pas periudhës për vitin e mbyllur më 31.12.2025	13



FILTO AUDITING

Filto Auditing Sh.p.k
Sheshi Wilson,
Kulla Fati, Kati i VIII,
Tiranë, Shqipëri

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Bordin e Mbikëqyrjes Publike
Rruga Ismail Qemali Ndërtesa nr. 22, Hyrja 4,
Kati i 5-të, Apartamenti nr. 24, Njësia administrative nr. 5, Tiranë

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, (në vijim referuar si “BMP”) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2025, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënime të tjera lidhur me to.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, më 31 dhjetor 2025, performancën financiare të saj dhe flukset e parasë të saj për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me kërkesat ligjore në Shqipëri të përcaktuara në Ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si edhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat Financiare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë audituar nga auditues të tjerë të cilët kanë shprehur një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra më 17 nëntor 2025.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat ligjore në Shqipëri të përcaktuara në Ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si edhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e BMP për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e BMP, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të BMP.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të BMP.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e BMP për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që BMP të ndërpresë veprimtarinë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë, 27 prill 2026

FILTO Auditing Shpk -

Olnida Çobo,

Audituese Ligjore

Partner Angazhimi



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	4	22,962,780	22,084,129
Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm	5	19,395,938	21,485,899
Shpenzime të parapaguara	6	568,706	170,965
Të ardhura të konstatuara	7	1,417,000	1,417,000
Aktive afatgjata materiale	8	2,022,833	2,531,357
Aktive afatgjata jo materiale	8	121,186	142,891
TOTALI I AKTIVEVE		46,488,444	47,832,241
DETYRIMET			
Të pagueshme	9	3,186,721	4,332,669
Të ardhura të marra në avancë	10	4,486,000	380,000
TOTALI I DETYRIMEVE		7,672,721	4,712,669
AKTIVET NETO			
Aktivitet neto të pakufizuara		38,815,723	43,119,572
Totali i Aktiveve Neto		38,815,723	43,119,572
TOTALI I DETYRIMEVE DHE AKTIVEVE NETO		46,488,444	47,832,241

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 4 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese të BMP për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 janë hartuar dhe nënshkruar më datën 16 prill 2026, si më poshtë:

Sara Nika
Specialiste për Financën dhe Buxhetin e
Komanduar



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Aktiviteteve

		Viti i mbyllur më Shënime 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
TË ARDHURAT			
Të ardhura mbi honorarët e auditimit të NJEIP (3%)	11	24,551,276	23,280,172
Të ardhura nga fonde të tjera si kontribut i organizatave profesionale	11	6,719,968	7,857,205
Të ardhura nga tarifët e provimeve të aftësimit profesional	11	4,350,000	17,920,000
Të ardhura nga tarifa e regjistrimit në provimet e aftësimit profesional	11	3,916,000	4,226,000
Të ardhura nga masat disiplinore	11	-	150,000
Të ardhura të tjera	11	213,055	1,318,702
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara		39,750,300	54,752,078
SHPENZIME PËR AKTIVITETET			
Shpenzimet për pagat dhe sigurimet e strukturës mbështetëse	12	18,616,174	18,480,952
Honorarët e anëtarëve të BMP	12	5,928,000	5,544,500
Ekspertë të jashtëm të angazhuar pranë BMP	12	750,000	776,000
Shërbime të auditimit ligjor	12	619,200	-
Honorarë për komisione të ngritura nga BMP	12	2,595,000	1,240,000
Shpenzime për organizimin e provimeve	12	3,718,310	9,143,660
Shpenzime amortizimi	12	792,229	540,927
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	12	10,870,745	9,335,834
Totali i shpenzimeve		43,889,657	45,061,872
Të ardhura/ (shpenzime) bankare dhe diferenca kurs këmbimi		(164,492)	(252,729)
Rritja/ (Rënia) në aktivet neto të pakufizuara		(4,303,849)	9,437,477
Aktive neto në fillim të vitit		43,119,572	33,682,094
Aktive neto në fund të vitit		38,815,723	43,119,572

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 4 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare

		Viti i mbyllur më	Viti i mbyllur më
	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Fluksi parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit			
Ndryshimet në aktivet neto		(4,303,849)	9,437,477
<i>Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet e shfrytëzimit:</i>			
Shpenzime amortizimi	9	792,229	540,927
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra (Rritje/ Rënie në të drejta dhe interes i arkëtueshëm dhe shpenzime të parapaguara</i>	5, 6	(1,692,220)	4,809,225
Rritje/ (Rënie) në të pagueshme	9	(1,145,948)	648,438
Rritje/ (Rënie) në të ardhura të marra në avancë	10	4,106,000	(1,425,000)
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		1,140,651	4,392,616
Fluksi parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata material dhe jo materiale	8	262,000	2,098,372
Fluksi neto nga aktivitetet investuese		262,000	2,098,372
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre		878,651	2,294,244
Mjete Monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		22,084,129	19,789,885
Mjete Monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	4	22,962,780	22,084,129

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 4 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1 Informacion i Përgjithshëm

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) është një autoritet rregullator i pavarur me numër regjistrimi pranë organeve tatimore NUIS L72212451Q. BMP ushtron veprimtarinë e tij në bazë të Ligjit nr. 10091, datë 5 Mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dhe rregullatore në zbatim të këtij ligji.

Selia e autoritetit ndodhet në adresën: Rruga Ismail Qemali, Ndërtesa nr. 22, Hyrja 4, Apartamenti nr. 24, Kati i 5-të Njësia administrative nr. 5, Tiranë.

Më datën 31 dhjetor 2025, numri i personelit të përhershëm të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) është 9 (nëntë). Numri mesatar i punonjësve për vitin 2025 ka qenë 8 punonjës.

2 Baza e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur, në përputhje me kërkesat ligjore në Shqipëri të përcaktuara në Ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si edhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF). Sipas SKK për OJF, për hartimin e pasqyrave financiare zbatohet kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara.

Pasqyrat financiare përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e aktiviteteve (performancës) si edhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare. Gjithashtu pjesë përbërëse e pasqyrave financiare janë shënimet shpjeguese për dhënien e informacioneve të tjera shtesë të nevojshme për të kuptuar llojin e aktiviteteve dhe shërbimeve të kryera.

Pozicioni financiar i BMP është përcaktuar nga aktivet, detyrimet dhe aktivet neto në fund të periudhës raportuese, ndërsa pasqyra e aktiviteteve (performancës) përcaktohet nga marrëdhënia mes të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese duke paraqitur shumat e ndryshimeve të aktiveve neto.

Politikat kontabël më poshtë paraqesin të plotë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

2 Baza e përgatitjes (vazhdim)

2.3 Parimi i Vijimësisë

Pasqyrat financiare përgatiten mbi supozimin e vijimësisë, i cili merr parasysh se BMP do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të tij për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra janë prezantuar në Lekë (ALL), monedha shqiptare, e cila është monedha funksionale e BMP.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

3.1 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve për aktivitetet

Të ardhurat dhe shpenzimet për aktivitetet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 janë njohur mbi bazën e parimit e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Për mbledhjen e të ardhurave për ushtrimin e veprimtarisë së saj, BMP bazohet në zbatimin e kërkesave ligjore për ligjin mbi auditimin si edhe Rregullores për Procedurat dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike. Shuma e të ardhurave nga organizatat profesionale është miratuar me vendim të BMP. Të ardhurat nga provimet dhe të ardhurat nga regjistrimet janë përcaktuar në bazë të arkëtimit të kryera nga kandidatët për provimet e vitit përkatës raportues, sipas tarifave të miratuara të provimeve të aftësive profesionale. Të ardhurat mbi honorarët e auditimit të NJEIP (3%) janë përcaktuar në bazë të deklarimeve të kryera nga audituesit ligjorë pranë BMP brenda muajit Janar të çdo viti pasardhës. Burime të tjera financimi për ushtrimin e veprimtarisë së BMP janë të ardhurat nga arkëtimi i gjobave të vendosura nga organizatat profesionale, pagesat për masat disiplinore “dënim me gjobë” si dhe fonde të tjera nga burime të ligjshme.

Shpenzimet për aktivitetet të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e bëra gjatë vitit dhe shpenzimet e kryera për aktivitetet e vitit të cilat nuk janë paguar deri në fund të vitit.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë ato transaksione të cilat kryhen në monedhë të ndryshme nga monedha e saj funksionale. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit.

Diferencat nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Këto diferenca njihen në pasqyrën e aktiviteteve.

Kursi zyrtar i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2025 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
LEK/ 1 EUR	96.77	98.15

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.3 Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në llogaritë rrjedhëse në bankë dhe depozitat në para në banka të nivelit të dytë. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozitat me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3.4 Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit paraqiten me koston e tyre historike.

3.5 Të ardhurat e konstatuara

Të ardhurat e konstatuara janë matur me vlerën e drejtë të arkëtueshme dhe përbëjnë të drejtat e arkëtueshme nga vlera që pritet të rikuperohet nga proceset gjyqësore.

3.6 Aktivët Afatgjata Materiale

(a) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afat-gjata materiale paraqiten me koston e tyre të blerjes duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kosto përfshin edhe shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (elementët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël neto të aktivit afatgjatë material dhe pasqyrohet në pasqyrën e aktiviteteve.

(b) Kosto të mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(c) Amortizimi/Zhvlerësimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare, të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Jeta e dobishme të vlerësuar reflektohen nga normat vjetore dhe metodat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese si në vijim:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Pajisje informatike	Metoda Lineare	25%
Mobilje dhe orendi	Metoda Lineare	20%
Mjete Transporti	Metoda Lineare	20%
Të tjera	Metoda Lineare	20%

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.7 Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme në fund të vitit njihen me kosto historike.

3.8 Të ardhura të marra në avancë dhe të ardhurat e tjera

Të ardhurat e marra në avancë

Të ardhurat e marra në avancë maten me koston e tyre historike dhe janë të ardhura që janë arkëtuar në avancë për aktivitete që do të ndodhin në vitet pasardhëse.

Të ardhurat e tjera

Të ardhurat e tjera maten me kosto historike dhe janë të ardhura nga burime të tjera që vijnë si rrjedhojë dhe në përputhje me kërkesat ligjore, statutore dhe rregulloreve të tjera të miratuara nga Bordi i Mbiqëqyrjes Publike.

3.9 Të ardhurat/ shpenzime bankare/ kurs këmbimi

Të ardhura/ shpenzime bankare/ kurs këmbimi përfshijnë të ardhura nga interesit mbi llogaritë bankare, komisionet bankare dhe diferenca nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e aktiviteteve.

3.10 Tatimet

BMP është autoritet rregullator i pavarur, i cili vepron si Ent Publik dhe si i tillë nuk është subjekt i përgjegjësisë tatimore të tatimit mbi fitimin. BMP respekton dispozitat e ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimet në zbatim të tij në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin në burim.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

BMP paguan kontributet për pensione si për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar në pagat e përcaktuara sipas VKM nr.421, datë 26.06.2024, janë paguar për llogari të organeve përgjegjëse për pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

3.12 Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

*(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)***4 Mjete Monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet Monetare më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Mjete Monetare në bankë	22,962,780	22,084,129
Totali	22,962,780	22,084,129

5 Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm

Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të arkëtueshme mbi honorarët e auditimit të NJEIP (3%)	12,835,755	14,160,901
Të arkëtueshme nga kontributi i organizatave profesionale	6,375,183	6,093,691
Të arkëtueshme nga masat disiplinore	185,000	335,000
Shpenzime të parapaguara për organizimin e Konferencës në kuadër të projektit SQARP	-	896,307
Totali	19,395,938	21,485,899

6 Shpenzime të parapaguara

Shpenzime të parapaguara më datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Parapagime të dhëna - Garanci Qira Zyrat e BMP	170,966	170,965
Shpenzime të periudhave të ardhshme	397,740	-
Totali	568,706	170,965

7 Të ardhura të konstatuara

Të ardhura të konstatuara më datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura të konstatuara nga proceset gjyqësore	1,417,000	1,417,000
Totali	1,417,000	1,417,000

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

8 Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale

Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale më datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	<i>Paisje Kompjuterike</i>	<i>Mobilje dhe paisje zyre</i>	<i>Software e të ngjashme</i>	<i>TOTALI</i>
Lëvizje përgjatë 2024				
Vlera kontabël në fillim	180,104	936,699		1,116,803
Shtesat	1,623,362	330,310	144,700	2,098,372
Nxjerrjet jashtë përdorimit	-	-	-	-
Shpenzimi i zhvlerësimit për vitin	(227,935)	(311,183)	(1,809)	(540,927)
Vlera kontabël në fund	1,575,531	955,826	142,891	2,674,248
Më 31 Dhjetor 2024				
Kosto	3,005,282	2,648,678	144,700	5,798,660
Zhvlerësim i akumuluar	(1,429,751)	(1,692,852)	(1,809)	(3,124,412)
Vlera kontabël neto	1,575,531	955,826	142,891	2,674,248
Lëvizje përgjatë 2025				
Vlera kontabël në fillim	1,575,531	955,826	142,891	2,674,248
Shtesat	262,000	-	-	262,000
Nxjerrjet jashtë përdorimit	-	-	-	-
Shpenzimi i zhvlerësimit për vitin	(473,299)	(297,226)	(21,705)	(792,229)
Vlera kontabël në fund	1,364,232	658,600	121,186	2,144,019
Më 31 Dhjetor 2025				
Kosto	3,267,282	2,648,678	144,700	6,060,660
Zhvlerësim i akumuluar	(1,903,050)	(1,990,077)	(23,514)	(3,916,641)
Vlera kontabël neto	1,364,232	658,601	121,186	2,144,019

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

*(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)***9 Të pagueshme**

Të pagueshme më datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Detyrime për pagat e strukturës mbështetëse	-	21,250
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	306,167	306,519
Tatim në burim	259,915	328,860
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP)	598,759	568,290
Furnitorë (UKT, FSHU)	21,970	119,474
Detyrime për pagesat e 3% të mbi paguara	1,999,910	2,988,276
Totali	3,186,721	4,332,669

10 Të ardhura të marra në avancë nga procesi i provimit përfundimtar të aftësive profesionale

Të ardhura të marra në avancë nga procesi i provimit përfundimtar të aftësive profesionale më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura të marra në avancë - provimi 1	385,000	125,000
Të ardhura të marra në avancë - provimi 2	2,960,000	105,000
Të ardhura të marra në avancë - provimi 3	746,000	55,000
Të ardhura të marra në avancë - provimi 4	185,000	35,000
Të ardhura të marra në avancë - provimi 5	60,000	30,000
Të ardhura të marra në avancë - provimi 6	150,000	30,000
Totali	4,486,000	380,000

11 Të ardhurat

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura mbi honoraret e auditimit të NJEIP (3%)	24,551,276	23,280,172
Të ardhura nga kontributi i organizatave profesionale	6,719,968	7,857,205
Të ardhura nga tarifat e provimeve	4,350,000	17,920,000
Të ardhura nga tarifa e regjistrimit në provime	3,916,000	4,226,000
Të ardhura nga masat disiplinore	-	150,000
Të ardhura të tjera	213,055	1,318,702
Totali	39,750,300	54,752,078

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

12 Shpenzime për aktivitetet

Shpenzime për aktivitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Shpenzime për pagat e strukturës mbështetëse	16,442,071	16,320,884
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	2,174,103	2,160,068
Honorarët e anëtarëve të BMP	5,928,000	5,544,500
Honorarë për komisione të ngritura nga BMP	2,595,000	1,240,000
Ekspertë të jashtëm të angazhuar pranë BMP	750,000	776,000
Shërbime të auditimit ligjor	619,200	0
Shpenzime për organizimin e provimeve	3,718,310	9,143,660
Shpenzime amortizimi	792,229	540,927
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	10,870,745	9,335,833
Totali	43,889,657	45,061,872

Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme të detajuara sipas natyrës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Transferime, udhëtime dhe dieta	4,858,352	4,508,480
Qira	2,117,652	1,714,627
Shpenzime për anëtarësime dhe përfaqësime në organizatat ndërkombëtare	1,511,673	884,812
Mirëmbajtje dhe riparime	939,586	613,518
Shpenzime të tjera	619,134	729,640
Blerje materiale	289,020	267,140
Shpenzime energjie dhe uji	202,087	214,646
Shpenzime për programe kompjuterike dhe licenca	140,603	212,532
Shpenzime kancelarie	127,968	147,773
Shpenzime postare dhe interneti	64,670	42,665
Totali	10,870,745	9,335,833

13 Të ardhura/ shpenzime bankare/ kurs këmbimi

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura/shpenzime bankare/diferenca kurs këmbimi	(164,492)	(252,729)
Totali	(164,492)	(252,729)

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

*(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)***14 Informacione lidhur me procesin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale**

Informacione lidhur me procesin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura nga tarifa e provimeve	4,350,000	17,920,000
Të ardhura nga tarifa e regjistrimeve	3,916,000	4,226,000
Totali i të ardhurave nga aktiviteti	8,266,000	22,146,000
Shpenzime për organizimin e provimeve	1,169,310	3,383,620
Honoraret e anëtarëve të KPAP-së	1,975,000	4,040,000
Honoraret e Komisionit të Rishikimit	574,000	1,625,000
Printim certifikata dhe dëshmi për marrjen e provimeve	-	95,040
Totali i shpenzimeve për aktivitetin	3,718,310	9,143,660
Rritja në aktivet neto për aktivitetin e provimeve	4,547,691	13,002,340

15 Të ardhurat dhe shpenzimet për aktivitetet e BMP

Të ardhurat dhe shpenzimet për aktivitetet e BMP për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
TË ARDHURAT		
Të ardhura mbi honoraret e auditimit të NJEIP (3%)	24,551,276	23,280,172
Të ardhura nga kontributi i organizatave profesionale	6,719,968	7,857,205
Teprica të papërdorura nga proceset e provimit përfundimtar të aftësive profesionale	4,547,691	13,002,340
Të ardhura nga masat disiplinore	-	150,000
Të ardhura të tjera	213,055	1,318,702
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara	36,031,990	45,608,418
SHPENZIME PËR AKTIVITETET		
Shpenzimet për pagat e strukturës mbështetëse	18,616,174	18,480,952
Honoraret e anëtarëve të BMP	5,928,000	5,544,500
Honorare për komisione të ngritura nga BMP	2,595,000	1,240,000
Ekspertë të jashtëm të angazhuar pranë BMP	750,000	776,000
Shërbime të auditimit ligjor	619,200	-
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	10,870,745	9,335,834
Shpenzime amortizimi	792,229	540,927
Totali i shpenzimeve	40,171,348	35,918,212
Rritja/ (Rënia) në aktivet neto të pakufizuara	(4,139,357)	9,690,206

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

*(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)***16 Rritja/ Rënia në aktivet neto**

Rritja/ Rënia në aktivet neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Rritja/Rënia në aktivet neto për aktivitetet e tjera	(4,139,357)	9,690,206
Të ardhura/shpenzime bankare/diferenca kurs këmbimi	(164,492)	(252,729)
Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara	(4,303,849)	9,437,477


17 Masa disiplinore dhe çështje gjyqësore

Në lidhje me çështjet gjyqësore, për periudhën raportuese, nuk ka patur çështje të cilat do të krijojnë shpenzime shtesë për aktivitetin e BMP.

18 Ngjarjet pas periudhës për vitin e mbyllur më 31.12.2025

Në zbatim të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, Rregullores “Për procedurat dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike”, Rregullores “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit”, audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që kryejnë auditime ligjore të njësisve ekonomike me interes publik, si dhe të njësisve ekonomike që nuk janë me interes publik të regjistruara në regjistrin publik ose që kanë qenë të regjistruara përkohësisht në regjistrin publik përgjatë periudhës së raportimit që ka filluar më 1 janar 2025 deri më 31 dhjetor 2025, kanë raportuar pranë BMP informacionin sipas formatit të unifikuar të Raportimit të Angazhimeve, si edhe është realizuar nga struktura mbështetëse e BMP verifikimi i saktësisë i të dhënave të deklaruara, për efekt të konstatimit lidhur me të drejtat dhe detyrimeve dhe të të ardhurave.

Efektet financiare që mund të lindin nga këto rakordime do të njihen në raportimin e periudhave pasuese, sipas konstatimit dhe matjes së besueshme.



RAPORTI I VEPRIMTARISË 2025

bmp

BORDI I
MBIKËQYRJES
PUBLIKE